



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", me profile: "Atletikë", "Gjymnastikë", " Futboll", "Lojra me Dorë", "Gazetari" "**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**"Universiteti European i Tiranës"**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1.Prof. Asc. Roland Çerepi

2.Prof. Asc. Robert Çitozi

Shtator / 2022



**Për Programin e studimit Bsc në "Edukim Fizik dhe Sporte", me profile: "Atletikë", "Gjinnastikë", " Futboll", "Lojra me Dorë", "Gazetari"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjise, Edukimit dhe Sporteve
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor "Edukim Fizik dhe Sporte", me profile: "Atletikë", "Gjinnastikë", " Futboll", "Lojra me Dorë", "Gazetari"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Licensim: UMASR Nr. 558 datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.A 2020-2021 – 22 PAE/4 PAK V.A 2019-2020 – 16 PAE/6 PAK V.A 2018-2019 – 9 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2021-2022 – 71 të rregjistruar V.A 2020-2021 – 74 të rregjistruar V.A 2019-2020 – 101 të rregjistruar
19	Komente / të tjera:	-



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës;



Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, shkurtimisht BA në “Edukim Fizik dhe Sporte (EFS)”, është hapur me Urdhër të Ministriat të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 558, datë 12.09.2018, si program i studimeve universitare të ciklit të parë në fushën e edukimit fizik dhe sporteve. Në përputhje me pikën 2 të UMASR Nr. 558, datë 12.09.2018, programi i studimit filloi veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 dhe është në proces akreditimi për herë të parë.

Programi ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 528, datë 04.09.2018, “Për riorganizimin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në Universitetin European të Tiranës”.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit studentët fitojnë diplomë “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte”, në secilin prej profileve “Atletikë”, “Gjimnastikë”, “Futboll”, “Lojëra me Dorë” 5, “Gazetari”.

Ky program studimi i konceptuar me pesë profile krijon mundësi inter-disiplinariteti brenda fushës së formimit bazë dhe synon përgatitjen e specialistëve në fushën e aktivitetit fizik dhe sporteve duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në mësuesi apo një nga drejtimet e fushës së sporteve dhe informacionit sportiv.

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Të kombinuara së bashku këto dimensione e pajisin studentin në Bachelor me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi bazë në lidhje me punën apo specializimin e mëvonshëm si sportist dhe edukator sportiv.





## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Universiteti European i Tiranës, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar me shkresë Nr. 155, datë 18.12.2020, për akreditimin e programit.

Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”, i ndryshuar.

Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga: Prof. As. Robert Çitozi. Prof. As. Roland Çerepi, Detyra e ekspertëve të jashtëm ishte përpilimi i raportit të vlerësimit të jashtëm, mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni dhe gjetjeve gjatë kryerjes së vizitës në institucion. Grupi i punës u mbështet gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm nga koordinatorja teknike e ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Me kryerjen e aplikimit, UET ka realizuar procesin e vlerësimit të brendshëm dhe nëpërmjet shërbimit në AMS ka nisur raportin e vlerësimit të brendshëm RVB dhe dokumentacionin mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetë-Vlerësimit të programit (DVV).


Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Urdhër Nr. 27 datë 15.03.2022 të ASCAL “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti European i Tiranës”.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi i ekspertëve të jashtëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 8072015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it të vëna në dispozicion nga sistemi AMS.

Ecuria e procesit të vlerësimit ka vazhduar në përputhje me axhendën e punëve të përcaktuara nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi dhe vizitën në institucion në datë 04.04.2022, ku mori takime të rëndësishme me aktorët kryesorë të këtij programi studimi duke filluar me Dekanen e Përgjegjësën e njësisë bazë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, me personelin administrativ, sekretarinë mësimore dhe më pas vizitoi ambientet e reja të UET dhe ambientet ku realizohet mësimdhënia teorike e praktike për këtë program studimi.

Pas vizitave në UET, grupi i punës filloi hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm në përputhje me të gjitha templates apo guidën e hartimit të tij.

“Universiteti European i Tiranës” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04/08/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/90 Prot, datë 04/08/2022. “Universiteti European i Tiranës” përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 78/112 Prot., datë 29/08/2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.





Pasi morëm relacionin dhe komentet e GVB të institucionit UET mbi Draft – RVJ dorëzuar nga ne ekspertët e jashtëm Robert Çitozi dhe Roland Çerepi, **GVJ sqaron si vijon:**

**1. Konstatime lidhur me kualifikimin e stafit akademik të programit të studimit:**

**Standardi I.4 / Kriteri 1;**

**Standardi II.2 / Kriteri 2, 3 dhe 5;**

**Standardi II.3 / Kriteri 6;**

**Standardi II.5 / Kriteri 1;**

**Standardi III.4 / Kriteri 4.**

**Koment nga Universiteti:** Institucioni bën përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në këtë drejtim, duke nxitur rekrutimin e personelit akademik me tituj dhe grada, si dhe duke motivuar personelin akademik aktual, për një zhvillim të mëtejshëm akademik. Bëjmë me dije, punësimin e Prof. Dr. Agron Cuka, si një shembull i rekrutimit cilësor në personelin akademik, të programit.

**Koment nga GVJ:** Pasi lexuam komentet dhe duke patur dhe marrë informacion edhe mbi përpjekjet e institucionit që edhe pas vizitave tona në institucion, konstatojmë që ka përpjekje të vazhdueshme dhe qëndrueshme për të nxitur rekrutimin e personelit akademik me tituj dhe grada si në rastin e punësimit të Prof. Dr. Agron Cuka një aset i shkencave sportive.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---

**2. Standardi II.5 / Kriteri 5**

**Vlerësimi i ekspertëve:** “Në RVJ thuhet: Për programin e studimit BA në Edukim Fizik dhe Sporte nuk parashikohen orë laboratorike! GVJ gjykon që studentët mundet të frekuentojnë laboratorin e informatikës apo TIK si dhe ato të shkencave biomjekësore duke i paraprirë kështu ciklit të dytë të studimit. Kriteri përmbushet pjesërisht.”

**Koment nga Universiteti:** Konstatimi i ekspertëve për vlerësimin në RVB është i saktë, mirëpo rezultojnë të jetë një lapsus nga ana e grupit të punës. Duke shfrytëzuar rastin, meqënëse gjatë diskutimeve në vizitën e Ekspertëve nuk u konsultua si diskutim, dëshirojmë të plotësojmë informacionin se për lëndë të caktuara si “Bazat e Informatikës”, “Statistika e aplikuar”, “Anatomi I&II”, “Fiziologji”, orët e mësimin zhvillohen në laboratorët e Informatikës dhe laboratorët përkatës të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (**DVV Ref. Nr. 14.1: Plani mësimor i programit**).

**Koment nga GVJ:** Gjatë vizitës në institucionin UET ne si GVJ nuk e konstatuam bashkëpunimin midis fakulteteve edhe në përdorimin e aseteve të njëra tjetrës sic janë laboratorët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike ndaj marrim në konsideratë sqarimin e GVB-së.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**



### 3. Konstatime lidhur me infrastrukturën në dispozicion të programit të studimit:

Standardi III.3 / Kriteri 1, 2 dhe 7;

Standardi III.7 / Kriteri 1;

Standardi IV.3 / Kriteri 3.

**Koment nga Universiteti:** UET, disponon ambiente fizike për zhvillimin normal të orëve të praktikës, për të gjitha disiplinat me karakter profesional, gjithashtu, Departamenti, shfrytëzon më së miri marrëveshjet ndërinstitucionale, në funksion të zhvillimit cilësor të procesit akademik si dhe zhvillimin e procesit të praktikës profesionale.

**DVV Ref. Nr. 42 – 42.1. Infrastruktura në dispozicion të programit.**

**Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale (DVV Ref. Nr. 32/Aneks Tabela 5); Marrëveshjet e bashkëpunimit (DVV Ref. Nr. 34.1 – 34.7); Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (DVV Ref. Nr. 32.1)**

**Koment nga GVJ:** Pas rishikimit të kontratave dhe marrëveshjeve që UET ka me të tretë kryesisht terrene sportive, palestra, klube sportive, GVJ merr në konsideratë që procesi mësimor realizohet brenda standarteve dhe ka garancitë që në kampusin e ri që do të investohet nga aksionerët diku pranë TEG, ambientet sportive do të jenë moderne dhe bashkëkohore.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---

### 4. Standardi III.6 / Kriteri 3

**Vlerësimi i ekspertëve:** “GVJ gjykon që provimet lëndore duhet të vlerësohen të paktën nga 2 pedagogë gjë e cila do të shmangte subjektivizmin dhe do ulte ankimimet nga ana e studentëve.”

**Koment nga Universiteti:** Për sa i përket provimeve lëndore, për të siguruar shmangien e subjektivizmit në UET ato zhvillohen në anonimat të plotë përmes sekretimit nga punonjëset e Sekretarisë Mësimore. Pas përfundimit të provimit, tezat e korrigjuara nga pedagogu/pedagogët e lëndëve, dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student nominalisht (**DVV Ref. Nr. 7.1: Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve**). Ankesat e studentëve trajtohen nga Departamenti, nëpërmjet komisionit të posatshtëm, sipas një procedure të caktuar (**DVV Ref. Nr. 7: Rregullore e programit të studimit, Pika 5.8**). Ndërsa për cilësinë e zhvillimit të procesit të provimeve, kryhen kontrollet përkatëse nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), mbi; a. përputhshmërinë ose jo të tezës me formatin standard të UET, b. cilësinë e korrigjimeve të tezave, c. rivlerësimet e tezave (**Dok.Shtesë Ref. Nr. 4.1: Ekstrakt – Raporti i Kontrollit të Provimeve\_2021-2022**).

Këto mekanizma që sigurojnë ruajtjen e anonimatit dhe cilësinë e zhvillimit të provimeve, funksionojnë më së miri në UET, duke garantuar vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti (Standardi III.6), prandaj lutemi që GVJ të rishikojë vlerësim e mësipërm. Shtojmë këtu që çdo IAL ka të drejtën të ndërtojë mekanizmat e tij për të garantuar standardet e cilësisë. Sugjerimet janë të mirëpritura, por kurrsesi nuk mund të jenë



të detyrueshme nëse nuk specifikohen tek kriteret e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 duke u kuadruar në elementët e autonomisë universitare.

**Koment nga GVJ:** Duke riparë edhe njëherë dokumentacionin shtesë të vendosur në dispozicion nga GVB, GVJ rishikon komentin e saj dhe duke krijuar bindjen që në UET është i garantuar vlerësimi i drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---

### 5. Standardi III.6 / Kriteri 3

**Vlerësimi i ekspertëve:** “GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë Edukimit dhe Sporteve duhet të krijojë kontaktet dhe netëork-un e vet në mënyrë që edhe studentët e programeve të studimit të sporteve të fillojnë me mobilitetet në universitetet partnere kryesisht në Europë. Fakti që në dokumentacion theksohet se asnjë student i këtij programi studimi nuk ka realizuar mobilitet në kuadër të Erasmus + tregon që departamenti ka shumë punë përpara.”

**Koment nga Universiteti:** Edhe gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm, grupi i punës vlerësoi se duhet të shtoheshin përpjekjet për të patur rezultate konkrete drejt rritjes së numrit të bashkëpunimeve me institucione homologe ndërkombëtare në funksion të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, duke e konsideruar si një ndër prioritetet kryesore për këtë program studimi në vijim (DVV Ref. Nr. 4: **Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit**).

Përvoja e gjatë dhe e suksesshme e vet Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve në këtë drejtim me programet e tjera të tij, është një bazë e fortë për të hedhur hapa përpara në këtë drejtim. Lutemi që GVJ të mbajë në konsideratë se programi i studimit është i ri dhe situata e shkaktuar nga pandemia Covid-19 ndikoi negativisht në krijimin e partneriteteve të reja, për sa kohë që edhe ato ekzistuese u pezulluan për një periudhë thuajse 2 vjeçare. Në vijim, Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve që është një nga pikat e forta në UET, do të ketë në fokus përfshirjen në projektet Erasmus + KA2 për studentët e këtij programi.

**Koment nga GVJ:** Pas analizimit me përgjegjshmëri të komenteve të institucionit nga ana jonë si GVJ, pranojmë argumentimin që jemi përpara një programi të ri studimi me një jetëgjatësi jo më shumë se 4 vjeçare kun ë këto katër vite pandemia që zgjati mbi dy vite paralizoi pothuajse gjithshka në lëvizjet, kontaktet dhe imobilitetet e studentëve dhe stafëve akademike dhe ka besimin që në vazhdim UET do të ketë në fokus përfshirjen në projektet Erasmus + KA2 për studentët e këtij programi.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---

### 6. Standardi III. 8

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

**Koment nga Universiteti:** Në vlerësimin e ekspertëve nuk konstatohen elementë që të çënojnë përmbushjen e ndonjë prej kriterëve në përmbajtje të këtij standardi, madje në përfundimet e vlerësimit të secilit prej kriterëve, gjejmë shprehimisht “Ky kriter përmbushet plotësisht”. I lutemi GVJ të rishikojë shkallën e përmbushjes së këtij standardi.

**Koment nga GVJ:** GVJ pasi iu rikthye standartit konstaton që ka qenë një lapsus i yni në vlerësimin e tij dhe beson në mirëkuptimin e GVB-së mbi këtë gjë.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---

## 7. Standardi II.3 / Kriteri 6

### Standardi II.4 / Kriteri 6

Konstatime për syllabuset dhe literaturën.

**Koment nga Universiteti:** UET, ka një eksperiencë disavjeçare lidhur me standardizimin dhe rregullsinë e hartimit, monitorimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të programeve lëndore, (silabuset), në këtë këndvështrim, Departamenti inkurajon, monitoron dhe zbaton procedurat ligjore në fuqi, duke nxitur bashkëpunimin krijues si dhe duke patur parasysh, rinovimin e programeve lëndore, bazuar në ndyshimet, ndër vite në literaturën përkatëse, bazuar në azhurnimin shkencor të disiplinave sportive.

**Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës, pika A.III.8 (DVV Ref. Nr. 39)**

**Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, Pika A.III.12.2 (DVV Ref. Nr. 39)**

**Koment nga GVJ:** GVJ e rivlerëson punën që bëhet në UET mbi standardizimin dhe rregullsinë e hartimit, monitorimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të programeve lëndore, rishikon vërejtjet e bëra mbi kryesisht syllabet sepse shumica e tyre janë korrekte, por lëmë porosi që edhe ato mangësi që janë konstatuar të rishikohen në vazhdimësi. Përsa i përket pikës mbi titullarët e lëndëve MSc kjo lidhet dhe me standartin e shtimit të rekrutimeve me grada e tituj dhe besojmë që do mbetet në konsideratën e departamentit përgjegjës.

**Komentet merren përgjithësisht parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**


---

## 8. Standardi I.3 / Kriteri 2

### Standardi II.4 / Kriteri 9

Konstatime për studimin e tregut të punës

**Koment nga Universiteti:** Lidhur me nevojën konstante të azhurnimit të njohurive si dhe nevojave të studentëve, por edhe si një nevojë akute e inkuadrimin të studentëve në tregun e punës, Departamenti, organizon, minimalisht, dy herë në vit, takime me anëtarët e Bordit të





Tregut të Punës. Ky organ kolegjal, është i atashuar pranë Departamentit dhe ka një rol të theksuar këshillimior. BTP, përbëhet nga Alumni të UET, profesionistë të fushës përkatëse, duke krijuar, kështu, një panoramë të qartë të nevojave të tregut të punës, si dhe mundësitë për punësim, të studenteve.

**Dok.Shtesë Ref. Nr. 8.1: Procesverbal i mbledhjes së fundit me BTP, dt. 02/02/2022**

**Koment nga GVJ:** GVJ është i bindur nga dokumentacioni i paraqitur që Departamenti, organizon, minimalisht, dy herë në vit, takime me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës. Ky organ kolegjal, është i atashuar pranë Departamentit dhe ka një rol të theksuar këshillimior. BTP, përbëhet nga Alumni të UET, profesionistë të fushës përkatëse, dhe për këtë arsye e kemi riformuluar vlerësimin e dy standarteve, por departamenti në vazhdim duhet të paraqesë apo hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës ndonëse edhe në këtë rast jetëgjatësia vetëm 4 vjeçare e programit të studimit nuk mundëson një database të plotë.

**Komentet merren përgjithësisht parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin në Draft – RVJ.**

---

**9. Standardi II.3 / Kriteri 5**

Vlerësimi i ekspertëve: “Në UET ndryshe nga të gjithë IAL-të publike apo private që ofrojnë këtë program studimi kandidatët për student i nuk nënshtrohen testimit praktik!”



**Koment nga Universiteti:** Bëjmë me dije se, regjistrimi i studentëve, në vitin e parë të studimeve, kryhet, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, gjithashtu, studentëve kandidat për t’u regjistruar në këtë program, duke patur parasysh karakteristikën e këtij programi, iu kërkohet dokumentacion shtesë, si psh. Raporti Mjeko-Ligjor, i cili është një dokument zyrtar i lëshuar nga komisioni mjekësor, ku paraqitet qartë aftësia apo paaftësia, për t’u bërë pjesë e këtij programi.

**Dok.Shtesë Ref. Nr. 9.1: Kopje e raportit mjeko-ligjor.**

**Koment nga GVJ:** GVJ gjykon që një raport mjeko-ligjor vërtet vlerëson gjëndjen e aftësisë për punë të individit, por në bindjen tonë një individ është i aftë por mund të ketë problematika të përballimit të ngarkesave fizike që nuk i teston dot ky kontroll. Sidoqoftë ne si GVJ e lëmë në gjykimin e departamentit nëse në vitet në vazhdim do të ndryshojë apo jo mënyrat e pranimit të kontigjenteve të rinj të studentëve në edukim fizik dhe sporte.

**Komentet merren parasysh dhe GVJ ndryshon formulimin dhe vlerësimin në Draft – RVJ.**

---





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, në secilin prej profileve “Atletikë”, “Gjmnastikë”, “Futboll”, “Lojëra me Dorë” dhe “Gazetari”.**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte thuhet se: “Misioni i Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve në realizimin e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimin për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare”.</p> <p>Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Protokoll i takimeve), GVJ konkludon që programi i studimeve Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në UET ofron një kurrikulë mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të mirëasimilueshëm, infrastrukturë moderne për pjesën teorike dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës.</p> <p>Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për një shoqëri më të shëndetshme dhe aktive nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitet fizik për shëndet dhe edukim fizik dhe sport.</p> <p>Programi i studimit “Edukim Fizik dhe Sporte” është në harmoni me interesat kombëtare dhe synon nxitjen dhe respektimin e tyre, në bazë të modelit të vizionit të UET.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2015-2020.</b></p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” ka funksionuar si program qysh nga viti akademik 2018-2019. Në Statutin e UET, Neni 6, pika 6.1 thuhet: “Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize tëspecializuar me ndikim në rajon e më gjërë si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në drejtimet specifike ku zotëron potencial”.</p> <p>Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e edukimit fizik dhe sporteve. Si i tillë, referuar RVB-së dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka</p>



	<p>dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike shkencore, kulturore kombëtare.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b></p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ-ja konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe syllabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe gjen që ky program studimi është konkurues në kuadrin kombëtar dhe ka ambicjen të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë së tij. Në RVB thuhet: “Ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Synimi i programit është të pajisë studentët me njohuritë bazë të fushës së edukimit fizik dhe sportit.”.</p> <p>Në këtë perspektivë duket qartë që ky program studimi zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b></p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Referuar kurrikulës së këtij programi studimi konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij programi studimi konstatohet që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur aktivitetin fizik për shëndet dhe sportet kudo ku ai angazhohet.</p> <p>Duke ju referuar Strategjisë së Kërkimit Shkencor në RVB thuhet: “Programi i studimit është hartuar në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar, në mbështetje edhe të vizionit të UET për të qenë një qendër ekselence me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal”.</p> <p>Nën këtë moto, programet në UET, hartohen dhe ofrohen në funksion të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar”.</p> <p><b>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</b></p> <p><b>Evidenca 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi I.2</b></p> <p><b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit thuhet: “Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve” mbështet planin strategjik të zhvillimit të programit për ciklin e parë të studimit “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” bazuar në përcaktimin e qartë të prioriteteve dhe objektivave strategjike, për përmbushjen me sukses të misionit të tij në këtë program studimi”.</p> <p>Kur e ballafaqojmë “Strategjinë dhe planin e zhvillimit strategjik të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>institucionit 2015-2020” me Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në UET bindemi se zbatimi i saj gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen, ku përmes shtyllës akademike synohet kryerja me efikasitet i procesit të mësimdhënies, me qëllim pajisjen e studentëve me dije bashkëkohore në fushën e mësimdhënies në edukim fizik dhe sporte nën udhëheqjen e një stafi akademik, përbërja e të cilit po përmirësohet ku ndërthuret cilësia sportive me aftësitë e spikatura akademike.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b>  <b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>GVJ-ja i konsultoi paraprakisht të dy dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Universitetit Europian të Tiranës dhe gjeti që në statut përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me Rregulloren e UET. Në mënyrë të veçantë programet e studimit të ciklit të parë hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin e UET.</p> <p>Zbatimi i përcaktimeve statutore dhe rregullore të institucionit konstatohet edhe në standartizimin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.</p> <p>Këto dy dokumenta themelore të normimit të aktivitetit insitucional gjykojmë që kanë shërbyer si bazë për hartimin dhe zbatimin e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në përputhje të plotë me bazën rregullative të UET-së.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b>  <b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Si një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar dhe liçensuar bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 636, datë 20.09.2006.</li> <li>- I akredituar me Vendim BA Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.</li> <li>- në zbatim të Urdhërit MASR Nr. 558, datë 12.09.2018, UET ka hapur program Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte</li> </ul> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar konfirmon që emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat dhe orientimet akademike të institucionit.</p> <p>Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave të DVV-së, konstaton që programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, i cili ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, si njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të UET.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Mësimore BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="566 1792 718 1859">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="718 1792 933 1859">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="933 1792 1157 1859">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="566 1859 718 1904"></td> <td data-bbox="718 1859 933 1904"></td> <td data-bbox="933 1859 1157 1904" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					



**Standardi I.3****Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në Rregulloren Mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte tek Objektivat e Programit të Studimit në pikën 3.3 thuhet: Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</li> <li>Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</li> <li>Formim qytetar të përgjithshëm;</li> <li>Aftësi bazë për punë kërkimore;</li> <li>Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative;</li> <li>Aftësim për promovim personal;</li> <li>Diplomë pa originalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë nëfushën përkatëse.</li> </ol> <p>Referuar RVB-së si dhe konkluzioneve dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporteve" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke nxitur pasionin për t'i thelluar njohuritë në ciklet e tjera të studimeve, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e rezultateve të analizave praktike, duke njohur konkurrencën në tregun e punës dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e aktivitetit fizik dhe sportit në një shoqëri e cila vuan nga palëvizshmëria, mbipesha dhe obeziteti.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b> <b>Evidenca 7. Rregullore Mësimore BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoni dokumentacionin e paraqitur nga IAL-ja del në konkluzionin se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidenca 16 – Argumentimi i hapjes së programit dhe</li> <li>- Evidenca 17 - Dokumenti i diskutimeve në Bordin e Tregut të Punës</li> </ul> <p>Nuk pasqyrojnë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, por një opinion i drejtuesve të njësisë kryesore apo asaj bazë.</p> <p>Studim tregu konsiderohet mbledhja dhe analizimi i të dhënave që një institucion apo organizatë kryen për të përcaktuar pozicionin e tij/saj në krahasim me konkurrencën si dhe përcakton kërkesat e tregut të punës për produktin apo shërbimin që ofrohet. Një studim tregu përfshin: një analizë SWOT, mbledhjen e të dhënave për konkurrencën e saj si dhe sondazhet që krijojnë një tablo të qartë të kërkesës së produktit në tregun e punës i brendshëm apo ndërkombëtar.</p> <p>Departamenti apo Bordi i Tregut të Punës apo Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit kanë të dhëna të përgjithshme apo opinione të marra nga burime të ndryshme si dhe nga vetë database të tij mbi punësimin e studentëve por dhe për kërkesat e tregut të punës. Është detyrë e UET, dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës që të mbledhin të dhëna në mënyrë të vazhdueshme për</p>




	<p>punësimin e studentëve duke gjurmuar ecurinë e tyre në tregun e punës.</p> <p>Në Evidencën 29 theksohet se: Bordi mbledhet së paku dy herë në vit për të konsultuar përputhshmërinë e përmbajtjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, dhe për të analizuar ecurinë e zhvillimit të praktikave dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës,”</p> <p><u>GVJ gjykon që departamenti përgjegjës i këtij programi studimi do të mundësojë në vazhdim një studim të mirëfilltë tregu sidomos për studentët e diplomuar.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 16. Argumentimi i hapjes së programit.</b></p> <p><b>Evidenca 17. Dokumenti i diskutimeve në Bordin e Tregut të Punës.</b></p> <p><b>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimin të tyre - Sporte.</b></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i pajis të diplomuarit me njohuri të thella teorike si dhe aftësim për kërkim shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sportit të mbështetur në metodat më bashkëkohore. Programi ka si objektiva mbështetur dhe në strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tu ofrojë studentëve dije, njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e edukimit fizik dhe sportit,</li> <li>- paisjen e studentëve me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra,</li> <li>- ti pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi në këtë fushë si dhe</li> <li>- të zhvillojë aftësinë e menaxhimit për çështje të edukimit fizik dhe lëvizor.</li> </ul> <p>Në RVJ theksohet: Departamenti kujdeset të përditësojë programin e studimit me zhvillimet më të fundit në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, ashtu edhe duke marrë në konsideratë dinamikën e tregut të punës. Diploma lejon kalimin në tregun e punës për ata të diplomuar që duan të punojnë në qendra të fitnesit, palestra, organizata jofitimprurëse me projekte nga fusha e sportit, administratë qendrore dhe vendore, qendra rekreacioni, institute sporti, etj.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Mësimore BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimin të tyre - Sporte.</b></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="635 1536 839 1603">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="839 1536 1043 1603">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1043 1536 1248 1603">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="635 1603 839 1648"></td> <td data-bbox="839 1603 1043 1648"></td> <td data-bbox="1043 1603 1248 1648" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura</p>	<p>UET me dokumentacionin e paraqitur na dëshmon se në tërësinë e tij</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





<p>në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>në nivel njësie kryesore ai ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi në atë fushë. Nga viti në vit pasqyrat dhe tabelat e paraqitura evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesshme.</p> <p>Në Departamentin përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, për vitin akademik 2021-2022 bazuar në të dhënat tabelore janë angazhuar në total 21 staf akademik ku <u>15 staf akademik PAE</u> prej të cilëve 1 me titullin Prof. Dr, 2 me titullin Prof. Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 8 Asistent Lektor - MSc. <u>PAK janë angazhuar 6 staf akademik</u> prej të cilëve 1 Prof. Dr, 3 Dr, 1 Doc dhe 1 MSc.</p> <p>Ka përpjekje të vazhdueshme dhe qëndrueshme për të nxitur rekrutimin e personelit akademik me tituj dhe grada si në rastin e punësimit të Prof. Dr. Agron Cuka një aset i shkencave sportive.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit, vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit, duke mundësuar si output për studentët fitimin e kompetencave (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) në përfundim të programit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p><b><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Tab 1&amp;2 Aneks.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” ofrohet në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Ky fakultet përmbledh fushat e studimit si Komunikimi, Filozofia, Historia, Gjuhësia, Letërsia, Psikologjia, Mësuesia, Sportet dhe Edukimi fizik, si edhe Artet.</p> <p>Vetë emërtimi i Fakultetit është një sintezë e të gjitha fushave të përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit.</p> <p>Ky rakordim vërtetohet edhe në programet e ofruara nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, ku përfshihet: Programi i Ciklit të Parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” si dhe 2 programe të tjera Bachelor, 2 Master Profesional dhe 2 Master i Shkencave (Total 7 programe).</p> <p>Programi mësimor është i është regjistruar si program i ciklit të parë Bachelor, Niveli 6 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe tenton të jetë i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL” i ndryshuar” dhe përpiqet të jetë korrekt me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p> <p><b><i>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>GVJ konstaton që fushat e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në kushtet e mungesës së kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 te ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” institucioni, që nga themelimi i tij ka zbatuar kodifikimin e vet të programeve të studimit dhe lëndëve në përputhje me fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Studimet ndërdisiplinore, të quajtura edhe studime të përgjithshme të mëdha dhe që përmbajnë një numër kursesh apo modulesh të ndryshme dhe që lejojnë përshtatjen e diplomës dhe mundësojnë zgjedhjen e disa varianteve studimore në vazhdim nuk ofrohen nga institucioni për momentin.</p> <p>Në një të ardhme do të ishte mirë që njësia kryesore dhe ajo bazë të mendojnë seriozisht për studime ndërdisiplinore të cilët zgjerojnë mundësitë e varianteve të studimit për studentët.</p> <p><b>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b></p> <p><b>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ konsultoi RVB-në si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion për përmbushjen e këtij kriteri. GVJ konstaton që UET ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues.</p> <p>Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, organizojnë veprimtari mësimore dhe shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua nga dekania e Fakultetit e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit për një sërë aktivitetesh me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve të tri njësisë bazë të fakultetit. Bashkëpunimi është i njëhësueshëm në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- aktivitetet e promovimit të institucionit,</li> <li>- në koordinimin e trajnimeve,</li> <li>- objektivat për rritjen e cilësisë së mësimdhënies e botimeve</li> <li>- në përdorimin e ambienteve të përbashkëta.</li> </ul> <p>GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p> <p><b>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e</b></p>



	<p><b>Dekanatit dhe Departamentit.</b>  <b>Evidenca 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit Detyrat e koordinatorit.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Konstatohet që UET ka një numër të madh marrëveshjesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron.</p> <p>UET ka një rrjet të konsiderueshëm marrëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikat profesionale të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj.</p> <p>UET disponon 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL kryesisht në Europë.” Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike. Gjithashtu, UET ka lidhur 5 marrëveshje me institucione të për zhvillimin e praktikave”.</p> <p><u>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike në të ardhmen e afërt.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET.</b>  <b>Evidenca 34.1. Marrëveshje Bashkëpunimi mes ZVA Tirane dhe UET Nr.64.Prot, date 19.04.2021.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ mësoi se çdo vit nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve hartohet një raport Vjetor i përfitimit prej marrëveshjeve në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve.</p> <p>GVJ konstaton se UET në funksion të realizimit të praktikave sportive ka disa marrëveshje bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me klube sportive, shoqata sportive, qendra rehabilitimi apo fitnesi etj.</p> <p>Në gjykimin tonë ky numër i konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave sportive, krijojnë kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësinë e duhur.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur na jep një pasqyrë të qartë se institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me aktorët në treg për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ai ofron.</p> <p>Bazuar në modalitetet e përcaktuara në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave mësimore sportive janë të</p>



	<p>rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisive të ndryshme të përfshira në këtë proces.</p> <p><b>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</b></p> <p><b>Evidenca 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlersimit të praktikës (nga Studenti).</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që UET ofron trajnime të mëtjshme profesionale për të diplomuarit në koordinim me punëdhënësit si: Panairin e Karrierës, Trajnim karriere Bordet e Tregut të Punës, Klubet studentore etj.</p> <p>Departamenti, bazuar në kalendarin vjetor të aktiviteteve, mbështet trajnime profesionale nëpërmjet leksioneve të hapura, ëorkshop-eve dhe udhëtimeve studimore.</p> <p>Në Universitetin Europian të Tiranës janë krijuar edhe funksionojnë disa klube studentore. Qëllimi i këtyre klubeve është që të pasurojë jetën sociale, artistike si edhe kulturore të studentëve si dhe të ofrojë mundësi për zbatimin në praktikë të njohurive edhe shpalsjen e talenteve të tyre</p> <p><b>Evidenca 3. Trajnime të mëtjshme profesionale.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</b></p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p><b>Standardi II.1</b></p> <p><b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra të rregullt. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41 datë 24.1.2018, e ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>A - duhen 15-20% janë faktike 36 ECTS ose 20% ✓</p> <p>B – duhen 50-55% janë faktike 95 ECTS ose 52.8% ✓</p> <p>C - duhen 12-15% janë faktike 24 ECTS ose 13.3% ✓</p> <p>D - duhen 10-15% janë faktike 18 ECTS ose 10% ✓</p> <p>E - duhen 3-5% janë faktike 7 ECTS ose 3.89% ✓</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	<p>organizuar në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban mesatarisht 30 ECTS.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS.</p> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks_Tabela 9).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” Pika 1 – Parime të përgjithshme thuhet: 1.2 Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. 1.3 Kjo rregullore përcakton aspektet organizative të programit të ciklit të parë të studimit. Ajo është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve</p> <p>Në pikën 3.1.2 të kësaj rregulloreje thuhet: Programi i studimit ofron mundësinë e profilizimit, përmes zgjedhjes së grup-lëndëve të kategorisë C të programit. Studenti mund të zgjedhë një nga këto profile studimi: Atletikë; Gjymnastikë; Futboll; Lojra me dorë; Gazetari si dhe grupe disiplinash të tjera, sporte në natyrë, lojra lëvizore, yoga, pilates, aerobi, bodybuilding, fitnes, stërvitje e adoptuar, etj, të cilat pajisin studentët me njohuri shtesë në specialitete të tjera, të lidhura me profesione të caktuara, ku ata mund të aplikojnë.</p> <p>Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në pikën 3.3 – Objektivat e programit të studimit thuhet: Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</li> <li>Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</li> <li>Formim qytetar të përgjithshëm;</li> <li>Aftësi bazë për punë kërkimore;</li> <li>Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative;</li> <li>Aftësim për promovim personal;</li> </ol>



	<p>g. Diplomë pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse.</p> <p>3.3.2. Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesione/mundësi punësimi të cilat janë listuar në Aneksin përkatës bashkëlidhur.</p> <p>3.3.3 Të diplomuarit në këtë program studimi duhet të kenë punuar/konspektuar/trajtuar listën e botimeve të paraqitur në Aneksin bashkëngjitur.</p> <p>Si pasojë programi ofron njohuri të përparuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teoriave dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke iu referuar Kurrikulës së Programit Studimor, vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuara në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin dytë e të tretë dhe që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjekësi sportive dhe rehabilitim,</li> <li>- psikomotorrika e moshave,</li> <li>- fitnes dhe stërvitjen e adaptuar,</li> <li>- teoria e stërvitjes sportive,</li> <li>- hartim dhe menaxhim projektsh,</li> <li>- praktikë dhe zhvillim karriere etj.</li> </ul> <p>GVJ mbështetur dhe në RVB arrin në konkluzionin se ky program studimi zhvillon aftësitë e studentëve për të zgjidhur probleme të fushave specifike të studimit nëpërmjet variacioneve të aplikimit të teoriave në forma veprimi metodologjike dhe praktike.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte janë në përputhje Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës..</p> <p>Kurrikula dhe programet e lëndëve (syllabuset), të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte, janë në përputhje të plotë me VKM-ët e mësipërme. Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është një program studimi i ciklit të parë. Ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është me kohë të plotë.</p> <p>Studimet përmbillen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në përfundim të tyre studentëve ju lëshohet nga institucioni diplomë</p>



	<p>“Bachelor”.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b></p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, "Për elementet programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Në kategorinë A bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 16 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 veprimtari përmblylëse e cila është provim përfundimtar, ose punim diplome për studentët me mesatare mbi 8.5.</p> <p>Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kategoria A - 20%</li> <li>- kategoria B – 52.8%</li> <li>- kategoria C – 13.3%</li> <li>- kategoria D – 10%</li> <li>- kategoria E – 3.9%</li> </ul> <p>Bazuar në legjislacionin në fuqi shpërndarja e lëndëve është e rregullt. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale përbëhet nga tre njësi bazë, apo departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit;</li> <li>- Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve;</li> <li>- Departamenti i Arteve të Aplikuara;</li> </ul> <p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", ka të angazhuar në total 21 staf akademik ku <u>15 staf akademik PAE</u> prej të cilëve 1 me titullin Prof. Dr, 2 me titullin Prof. Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 8 Asistent Lektor - MSc. <u>PAK janë angazhuar 6 staf akademik</u> prej të cilëve 1 Prof. Dr, 3 Dr, 1 Doc dhe 1 MSc.</p> <p>Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale është një njësi kryesore e re e Universitetit Barleti, është licencuar më Vendim UMASR Nr. 541, datë 10.09.2018.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>UET ka përmbushur standardet institucionale dhe është akredituar me Vendim BA Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. Pas riorganizimit të njësisë kryesore nga 3 fakultete në 5 fakultete akreditohet me Vendim BA Nr. 46, datë 05.07.2019 me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.</p> <p>Bazuar në “Kërkesën për akreditimin e parë të disa programeve të studimit, Universiteti European i Tiranës”, dhe në gjithë dokumentacionin shoqërues na rezultoi se njësisë kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><b>Evidenca 54.2 URDHER Nr.528, datë 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit në F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</b></p> <p><b>Evidenca 54.3 Vendimi i BA Nr. 12 date 07.04.2017 akreditimi periodik institucional.</b></p> <p><b>Evidenca 54.4 Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Per Akreditimin e UET. Shkresë Kërkesë për akreditimin e parë të disa programeve të studimit, Universiteti European i Tiranës.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Konstatohet se departamenti ka në strukturën e tij organike koordinatorin e departamentit. Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ofron 7 programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 programe Master</li> <li>- 3 programe Bachelor</li> </ul> <p>Në strukturën e njësisë bazë në UET është i parashikuar një koordinator për program studimi i cili e koordinon punën e tij me departamentin. Koordinator mundet të mbulojë brenda departamentit më shumë se një program studimi të njëjtë apo të përafërt. Ai harton raport periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësisë përgjegjëse Tab 3.</b></p> <p><b>Evidenca 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit Detyrat e koordinorit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ gjykon se njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe ajo bazë Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përgjegjëse për programin e studimit i përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Numri i stafit akademik me tituj dhe grada, garanton një strukturë efektive konform përcaktimeve të Ligjit 80/2015 dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Në këtë program studimi janë angazhuar në total 21 staf akademik ku <u>15 staf akademik PAE</u> prej të cilëve 1 me titullin Prof. Dr, 2 me titullin Prof. Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 8 Asistent Lektor - MSc. <u>PAK janë angazhuar 6 staf akademik</u> prej të cilëve 1 Prof. Dr, 3 Dr, 1 Doc dhe</p>



	<p>1 MSc.</p> <p>Mbi 70% e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik me kohë të plotë konform legjislacionit në fuqi.</p> <p>Në RVB theksohet se: Departamenti organizohet në grupe mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore. Departamenti zhvillon mbledhjet e zakonshme çdo të Martë.</p> <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Tab 1&amp;2_Aneks.</i></p> <p><i>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, për vitin akademik 2021-2022 bazuar në të dhënat tabelore janë angazhuar në total 21 staf akademik ku <u>15 staf akademik PAE</u> prej të cilëve 1 me titullin Prof. Dr, 2 me titullin Prof. Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 8 Asistent Lektor - MSc. <u>PAK janë angazhuar 6 staf akademik</u> prej të cilëve 1 Prof. Dr, 3 Dr, 1 Doc dhe 1 MSc.</p> <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Tab 1&amp;2_Aneks.</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Pothuajse Identik me kriterin 3 mësipër:</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe ajo bazë Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përgjegjëse për programin e studimit i përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Numri i stafit akademik me tituj dhe grada, garanton një strukturë efektive konform përcaktimeve të Ligjit 80/2015 dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Në Departamentin përgjegjës për këtë program studimi janë angazhuar në total 21 staf akademik ku <u>15 staf akademik PAE</u> prej të cilëve 1 me titullin Prof. Dr, 2 me titullin Prof. Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 8 Asistent Lektor - MSc. <u>PAK janë angazhuar 6 staf akademik</u> prej të cilëve 1 Prof. Dr, 3 Dr, 1 Doc dhe 1 MSc.</p> <p>Mbi 70% e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik me kohë të plotë konform legjislacionit në fuqi.</p> <p>Në RVB theksohet se: Departamenti organizohet në grupe mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore.</p> <p><i>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit Tab 1&amp;2_Aneks.</i></p> <p><i>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Tab 3.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1653 818 1713">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="818 1653 1042 1713">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1042 1653 1265 1713">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1713 818 1765"></td> <td data-bbox="818 1713 1042 1765"></td> <td data-bbox="1042 1713 1265 1765" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

**Standardi II.3**

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al



parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe ajo bazë Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p>Që nga viti 2017 funksionon platforma UET LMS i cili nënkupton një sistem menaxhimi online të mësimdhënies me të gjitha funksionet e tij. Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij me sistemin UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime të ndryshme për klasat e tij mësimore, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, materiale shtesë, vlerësimet e studentit etj.</p> <p>Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit (<a href="https://uet.edu.al/bachelor/">https://uet.edu.al/bachelor/</a>) dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.</b></p> <p><b>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është organizuar në lëndë (jo module) dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në Rregulloren e Programit të Studimit në pjesën: Struktura e programit të studimit theksohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E– ja.</li> </ul> <p>i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.</p> <p>Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është i</p>




<p>organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>organizuar sipas sistemit ECTS dhe sipas kategorive (A-E), dhe i qëndrojnë korrekt peshës së përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p>Orët në auditor për kredit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione; 11 orë auditor dhe 14 punë individuale</li> <li>- Seminar; 7 orë auditor dhe 18 p. individuale</li> <li>- Projekt/Ushtrime; 12 orë auditor dhe 13 p. individuale</li> <li>- Praktikë profesionale; 100 orë në auditor 25 p. individuale</li> <li>- Punim Diplome; 20 orë në auditor 155 p. individuale.</li> </ul> <p>Konstatojmë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti i parë ka 629 orë në auditor</li> <li>- Viti i dytë ka 617 orë në auditor</li> <li>- Viti i tretë ka 546 orë në auditor.</li> </ul> <p>Pra një total prej 1792 orësh në auditor ose afërsisht 10 orë për ECTS.</p> <p>Na rezulton se ngarkesa për një vit akademik është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti 1 = <u>62 ECTS në vit</u></li> <li>- Viti 2 = <u>62 ECTS në vit</u></li> <li>- Viti 3 = <u>56 ECTS në vit</u></li> </ul> <p><u>GVJ e gjen normale që departamenti të bëjë një rikalkulim të krediteve duke i shpërndarë ato nga 60 ECTS për vit akademik gjë e cila thjeshtëson dhe procesin e transferimit të krediteve për studentët.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte në UET përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor / jashtë auditorit, frekuentimin / ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në syllabet e lëndëve. Konkretisht, në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % niveli i diskutimit në seminare</li> <li>- 20 % detyra e kursit</li> <li>- 70 % provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Për frekuentimin e studentëve në ciklin e parë të studimit IAL ka vendosur detyrim 60% për veprimtaritë mësimore në auditor.</p> <p>Institucioni ka një rregullore të përcaktuar qartë mbi frekuentimin, ndjekjen e programit mësimor, por dhe penaltetet nese kjo rregullore nuk respektohet nga ana e studentit. Gjithashtu institucioni dhe departamenti që është përgjegjës për këtë program studimi kanë një rregullore e metodologji të qartë mbi vlerësimin e dijeve si gjatë vitit ashtu edhe në provime.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe</b></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p><b>Sporte.</b> <b>Evidenca 19. Syllabuse të lëndëve.</b></p> <p>GVJ konstaton se të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte në UET duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njëhësim studimesh.</p> <p>Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Pika 2 – Për t'u pranuar në këtë program studimi kandidati/studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale</p> <p>Procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve përcaktohen në Pikën 9 të këtij dokumenti. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/program të mëparshëm studimi parashikohet në rregulloren e fakultetit.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p>Konstatohet që në jo pak syllabe ka nevojë për korrigjime sidomos në drejtim të shpërndarjes korrekte të orëve, mosvendosjes korrekte të literaturës apo faqeve që i korespondojnë temës në librin e rekomanduar, mos vendosja korrekte në syllab e programit të studimit apo dhe temat e përkthyer jo saktë nga literatura e huaj.</p> <p>Gjykojmë që ky akreditim duhet të shërbejë për një rishikim të plotë të pjesës më të madhe të sillabeve.</p> <p><u>Problematikë që e theksuam edhe në takimet me drejtuesit gjatë vizitës në institucion është se nuk mundet të jetë titullar lënde një pedagog MSc. Fakti tregon që pothuajse me të gjitha lëndët sportive teorike e praktike është i njëjti fenomen që duhet korrigjuar në vazhdimësi.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>



	<b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b>		
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>UET përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti, dhe rregullohet përmes politikës së UET për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga Departamenti përkatës, Fakulteti, Zyra e Kurrikulave, Sistemet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Senatin Akademik, dhe më pas dosja e plotë arkivohet.</p> <p>Syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit që prezantohet në lëndë të ndryshme.</p> <p>Sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në planin mësimor bëhen deri në masën 20% për programe të akredituara. Shpesh arsye për ndryshim bëhen daljet e VKM-ve apo udhëzimeve të reja nga institucionet që drejtojnë e normojnë punën në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Alumni nxjerr shpesh në pah nevoja për përmirësim, ide të reja dhe propozime për ndryshime që përmirësojnë programet mësimore në përputhje me dinamikat apo nevojat e tregut të punës i cili kalon mes procesesh të vazhdueshme ndryshimesh e transformimesh.</p> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p> <p><b>Evidenca 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	


#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015, Neni 73 thuhet: “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.</p> <p>Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në përfundim të programeve të ciklit të parë të studimeve lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.</p>





	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sipas programit të studimit shpërndarja rezulton e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione; 588 orë</li> <li>- Seminare; 484 orë</li> <li>- Lab/Ushtime; 149.4 orë</li> <li>- Praktikë/Detyra; 450 orë</li> <li>- Praktikë Profesionale; 100 orë</li> <li>- Diplomë/Provim Formimi; 20 orë</li> </ul> <p>Në total për 3 vite akademike dhe 180 ECTS zhvillohen gjithsej:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1792 orë në auditor</li> <li>- 2708 orë punë individuale.</li> </ul> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks_Tabela 9).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C D dhe E.</p> <p>Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t'u punësuar pas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve si mësues të edukimit fizik dhe sportive por dhe në fushat e aktivitetit fizik për shëndet, fitnessit dhe rehabilitimit fizik.</p> <p>Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë dhe në vazhdim kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Konstatojmë që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks_Tabela 9).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Konstatojmë që lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), të përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Konkretisht rezulton se shpërndarja e lëndëve sipas kategorive rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A - duhen 15-20% janë faktike 36 ECTS ose 20% ✓</li> <li>B – duhen 50-55% janë faktike 95 ECTS ose 52.8% ✓</li> <li>C - duhen 12-15% janë faktike 24 ECTS ose 13.3% ✓</li> <li>D - duhen 10-15% janë faktike 18 ECTS ose 10% ✓</li> <li>E - duhen 3-5% janë faktike 7 ECTS ose 3.89% ✓</li> </ul> <p>Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e</p>





	<p>semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p> <p>Gjatë një viti akademik, organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 2 (dy) semestra me kohëzgjatje normale 14 javë”.</p> <p><b>Evidenca 10.4. Kalendarit akademik 2021-2022.</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks Tabela 9).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit është ndërtuar në përputhje me Kartën e Bolonjës, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e pasur të stafit, dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në UET parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin e krediteve dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p> <p>Bazuar në lëndët specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike.</p> <p>Në dokumentin mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës theksohet se ndiqet parimi i rrahëve dhe ka një shpërndarje të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 70% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë.</li> <li>- 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë, në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë:</li> <li>- 15% të programit e zënë analiza dhe kritika të teorisë dhe aplikimeve të fushës në përputhje me informacionin e ciklit të tretë:</li> </ul> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A. III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integritet të aspekteve teorike të informacionit që jep një lëndë dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Statuti i UET ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Neni 37, apo Rregullorja e UET Neni 11, 16 apo 35. Proceset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit U dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.</p> <p>Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe</p>



	<p>mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve apo vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b></p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p> <p><b>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</b></p> <p><b>Evidenca 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konkludon se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të syllabeve të programeve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” konstatohet se një pjesë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Por, konstatohet edhe disa problematika:</p> <p><u>-Ka syllabe ku është vendosur literatura pa faqet për tematikë.</u></p> <p><u>-Ka syllabe ku literatura nuk i korespondon tematikave.</u></p> <p><u>-Ka syllabe ku nuk korespondon programi i studimit.</u></p> <p>Sugjerojmë që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore.</p> <p>Harmonizimi i literaturës më bashkëkohore vendase me atë të huaj do të ishte më efektive për studentët dhe një honor për breza të tërë profesori që kanë vendosur kollanat e teorisë dhe praktikës sportive.</p> <p>Ky kriter plotësohet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 19. Syllabuset.</b></p> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë.</p> <p>Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Misioni i Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve në realizimin e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënie, kreativitetit, aftësisë për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>Ky kriter plotësohet plotësisht.</p>



	<p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Mësimore Bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte”.</b></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Edukim Fizik dhe Sport” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Lista e Profesioneve / Mundësive për punësim të studentëve që përfundojnë studimet në Programin “Bachelor” në Edukim Fizik dhe Sporte pranë Universitetit Europian të Tiranës janë: Qendra të fitnesit, qendra të kujdesit të peshës, palestra, organizata jofitimprurëse me projekte nga fusha e sportit, administratë qendrore dhe vendore, qendra rekreacioni, institute sporti etj.</p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Mësimore Bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte”.</b></p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstaton se evidencat e prezantuara si dhe konsultimet e bëra gjatë vizitës në institucion na qartësojnë që departamenti realizon dy herë në vit, mbledhje me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës dhe merr në konsideratë mendimet, propozimet dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të tij.</p> <p>GVJ sugjeron që departamenti të bëjë studime më konkrete të kërkesave të tregut të punës e tu shmanget opinioneve individuale.</p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 12.1 Bordi i tregut të punës.</b></p> <p><b>Evidenca 17. Dokumenti i diskutimeve në Bordin e Tregut të Punës.</b></p> <p><b>Evidenca 38. Analiza e departamentit Ba Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>UET disponon Rregulloren e Burimeve Njerëzore e cila synon të sigurojë një menaxhim aktiv të burimeve njerëzore duke hartuar dhe zbatuar procedura e rregullore, politika, programe dhe shërbime që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit.</p> <p>Vizioni i UET-së është bashkëpunimi me profesionistë duke ofruar shërbime, politika dhe sisteme të burimeve njerëzore innovative, të orientuara drejt rezultateve.</p> <p>Nga dosjet e personelit akademik dhe CV-të e tyre dalim në konkluzionin se: Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu evidencat na pasqyrojnë që mbi 70% e programit mësimor realizohet nga PAE apo stafi akademik me kohë të plotë konform udhëzimeve në fuqi.</p> <p><b>Evidenca 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.</b> <b>Evidenca 11.1. Shembull thirrje për staf akademik.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Pasqyrat dhe tabelat e paraqitura po ti analizojmë nga viti në vit evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesshme sic është rasti i rekrutimit të fundit i cili është Prof.Dr një personalitet i shkencave sportive prej gati 4 dekadash. Ata janë emra të spikatur në fushën e shkencave sportive, biomjekësore dhe sociale dhe garantojnë realizimin e plotë dhe efikas të programit të studimit.</p> <p>Në këtë program studimi për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në total 26 staf akademik ku 22 staf akademik PAE prej të cilëve 6 Dr, 2 Doktorant, 14 me gradën MSc. PAK janë angazhuar 4 staf akademik prej të cilëve 4 MSc.</p> <p>Kjo shkon në përputhje me rregullin që stafet akademike duhet të jenë në kualifikim një shkallë mbi programin e studimit ku japin mësim.</p> <p><u>Gjithashtu duhet parë numri i lëndëve që jep një pedagog i sporteve sepse është e pamundur që një pedagog të japë 4 apo 5 sporte të ndryshme kur diplomimin e ka vetëm për njërin prej tyre.</u></p> <p>Kriteri përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidencat 20. CV-të e stafit akademik.</b> <b>Evidenca 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA EFS.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik të programit të studimit, u konstatua se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në përgjithësi është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij.</p> <p>Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të sportit dhe shkencave sportive dhe atyre psikosociale e biomjekësore. Sipas RVJ - Ndarja e lëndëve është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të secilit prej tyre, specifikën e moduleve. Si rregull, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës.</p>



	<p>Kriteri përmbushet plotësisht. <i>Evidenca Dokumenti G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore (Ref. Nr. 11)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme, shiko tek dokumentacioni i ofruar (Evidenca 34 për institucionet bashkëpunuese). Marrëveshjet realizohen me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës sportive e profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve në Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me ndërmarrjet / punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella. Praktika e detyrueshme, mbikqyret bashkërisht nga mbikqyrësi në vendin e praktikës dhe anëtari i caktuar i stafit akademik të departamentit i cili quhet Këshilluesi i Karrierës.</p> <p>Në RVJ theksohet: Për studentët të cilët kryejnë një punim diplome, për të përmbyllur detyrimet e tyre (ata që plotësojnë kriterin e mesatares) departamenti vë në dispozicion të studentëve, stafin akademik të kualifikuar, për t'i udhëhequr gjatë realizimit të saj.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.</i> <i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</i> <i>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</i> <i>Evidenca 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET.</i> <i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjykon që studentët mundet të frekuentojnë laboratorin e informatikës apo TIK, Statistika e Aplikuar, si dhe ato të shkencave biomjekësore duke i paraprirë kështu ciklit të dytë të studimit.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se në UET konsiderohet prioritet që studentëve tu ofrohen metoda bashkëkohore të mësimdhënies, zhvillimi i të cilave parashikohet në syllabusin e lëndës/modulit që rishikohen çdo fillim viti akademik për të qënë i përditësuar me të rejat e fundit bashkë kohore.</p> <p>Gjithashtu UET ka hartuar një udhëzues për mësimdhënien dhe të nxënëtit. Ky udhëzues është një material që ndihmon në zhvillimin e formave pedagogjike të stafit akademik dhe në përmirësimin e procedurave të mësimdhënies dhe të të nxënëtit ku një rol të rëndësishëm luan përdorimi i platformës LMS (Learning Management System).</p> <p>Duke qenë se që nga Marsi 2020 u kalua për shkak të pandemisë në mësimdhënie online UET disponon një guidë instruktive për të kuptuarit, asimiluarit, mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies on-line.</p> <p>Kjo guidë gjykojmë se i ka mundur stafit akademik të UET instrumenta, teknika dhe strategji të efektshme për mësimdhënien on-line, duke pasur në fokus dhënien e leksioneve, nxitjen e diskutimeve dhe reagimeve të studentëve për të nxënëtit e tyre, por dhe ka mundur zbatimin e teknikave efektive të vlerësimit, për nxitjen e të nxënëtit dhe matjen e rezultateve të studentëve.</p> <p>Gjithashtu UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik, veçanërisht për asistent lektorët, të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit.</p> <p><i>Evidenca 9. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p> <p><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i></p> <p><i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i></p> <p><i>Evidenca 46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</i></p> <p><i>Evidenca 46.3. UET LMS Guidë për studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se në UET funksionon Zyra e Standarteve dhe e Cilësisë e cila funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015, me Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Në rregulloren e kësaj njësie përcaktohen mënyrat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji 80/2015, Kodi i Cilësisë dhe Standartet e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi kryhet duke zbatuar parimin e autonomisë institucionale.</p> <p>UET ka përcaktuar metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit në mënyrë periodike në lidhje me aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik.</p> <p>Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë: a) vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës: b)</p>



	<p>vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimin e tyre; c) vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; d) e vetëvlerësimi; e) rezultatet e raporteve të KSBC-së; f) vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (folloë-up); g) zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara. KSBC apo Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka si funksion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit.</li> <li>- Seicili anëtar i KSBC-së përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar.</li> <li>- Rezultatet publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit u vendosen në dispozicion dhe Dekanëve e Përgjegjësve të Departamenteve.</li> </ul> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b>  <b>Evidenca 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</b>  <b>Evidenca 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.</b>  <b>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në dokumentacionin e Sigurimit të Cilësisë në Pikën F.VII.4.3 thuhet se mbetet primare; Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik dhe ndihmës, përmes vlerësimit nga studentët (pyetësorë, fokus grupe, etj) si dhe kualifikimit të tij, përmes të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Në fund të çdo semestri studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndës, i cili bazohet në përvojën e shumë universiteteve të shquara. Paraqiten pyetje të shumta, me qëllim vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut.</p> <p>Nga ana tjetër, studentët janë vazhdimisht në kontakt me zyrën e dekanit të studentëve, përmes përfaqësuesve të tyre, të zgjedhur, ose individualisht. Shqetësimet apo vërejtjet mund të paraqiten në lidhje me lëndën ose pedagogun. Pyetësori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është i përbërë nga 11 pyetje dhe 1 opinion i përgjithshëm.</p> <p>Pyetësori kërkon pikëpamjet dhe komentet e studentëve për çështje të tilla si, mënyra e shpjegimit të lëndës, a e bën pedagogu lëndën interesante dhe a shpjegon me pasion, a nxit lënda interesin dhe mendimin kritik, vlerësimi i performancës së studentëve etj. Kjo pasohet nga një pyetje e hapur, e cila krijon mundësinë e sugjerimeve për përmirësimin e lëndës dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>



	<p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.</i></p> <p><i>Evidenca 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Konstatohet se pyetësi për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies në UET. Pyetësi zhvillohet në fund të çdo semestri. Rezultatet e përgjithshme të pyetësit bëhen publike në fund të çdo viti akademik në faqen kryesore të internetit të institucionit duke u siguruar në këtë mënyrë që këto rezultate të mos ndikojnë në objektivitetin e kryerjes së detyrës prej pedagogut.</p> <p>Njëkohësisht, në mënyrë periodike dhe në përputhje me planin, përgatiten raporte të vlerësimit të brendshëm, sipas legjislacionit përkatës.</p> <p>Rezultatet publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit u vendosen në dispozicion dhe Dekanëve e Përgjegjësve të Departamenteve.</p> <p><i>Evidenca 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të performancës në UET synon realizimin e vlerësimit për të gjithë personelin (akademik, kërkimor dhe administrativ) si dhe strukturat përkatëse, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Ky proces synon qartësimin e objektivave individuale të personelit në kuadër të atyre institucionale, verifikimin e realizimit të këtyre objektivave dhe analizimin e funksionimit të strukturave institucionale, vlerësimin e performancës së personelit dhe atij institucional.</p> <p>Një moment shumë i rëndësishëm është dhe plotësimi i Formularit të Vetëvlerësimit të Performancës së Personelit Akademik.</p> <p>Në raportin përfundimtar të procesit të vlerësimit synohet të paraqitet një tablo e qartë e të gjitha rezultateve të arritura dhe problematikave të evidentuara si dhe promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Të dhënat e mbledhura nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit diskutohen në mbledhjen e Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve për t'u njohur me modelet dhe praktikat e vlerësuara pozitivisht në mënyrë që të nxiten dhe motivohen shembujt më të mirë mes anëtarëve të departamentit.</p> <p>Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë email-i ose faqja e internetit e universitetit.</p> <p><i>Evidenca 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe qdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor GVJ konstaton se: Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Sipas programit të studimit shpërndarja rezulton e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione; 588 orë</li> <li>- Seminare; 484 orë</li> <li>- Lab/Ushtime; 149.4 orë</li> <li>- Praktikë/Detyra; 450 orë</li> <li>- Praktikë Profesionale; 100 orë</li> <li>- Diplomë/Provim Formimi; 20 orë</li> </ul> <p>Programi lëndor (syllabus) i secilës lëndë miratohet nga senati dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet rektoratit të UET përmes Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ndjek realizimin e aktiviteteve.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks Tabela 9).</i></p> <p><i>Evidenca 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza e departamentit Ba Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në universitet mësohet se Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve organizon veprimtari të larmishme sportive ose ëorkshope në mënyrë që të mbështesin procesin e mësimdhënies. Gjithashtu, stafi akademik monitoron me kujdes raste të veçanta dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë sa më herët çështjet problematike të studentëve që mund të ndodhin për arsye të ndryshme.</p> <p>Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike.</p> <p>Për të bërë harmonizimin e mësimdhënies ku ka diversitet në nevojat e studentëve, stafi akademik mbështetet edhe nga pedagogët që shërbejnë si koordinatorë për çdo vit akademik si dhe nga struktura të tjera siç është Zyra në Shërbim të Studentëve.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.</i></p>







	<p>mësimdhënies është pyetësi i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri nga ana e studentëve. Pyetësi aktivizohet para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Rezultatet e pyetësit përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>Departamenti organizon një herë në muaj mbledhje të hapur për studentët e programeve që administrojnë duke dëgjuar sugjerimet dhe problematikat e tyre në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Sa më sipër rezulton se institucioni vlerëson dhe përmirëson vazhdimisht format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët, si edhe duke reflektuar mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.</p> <p><b>Evidenca 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve.</b></p> <p><b>Evidenca 38. Analiza e departamentit Ba Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimimit.</p>	<p>Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarët. Studentët marrin pjesë në punë praktike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive.</p> <p>Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p>Ndërkohë një element shumë i rëndësishëm është pajisja e studentëve me njohuri për organizimin dhe zbatimin e lojrave sportive dhe sporteve individuale. Këto shihen si format kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve të edukimit fizik dhe sporteve.</p> <p><b>Evidenca 5.3. Rregullore tranzitore Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021.</b></p> <p><b>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b></p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, essetë, detyrat e kursit dhe punimet praktike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik.</p> <p>Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre.</p> <p>Për të rritur bashkëveprimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet bachelor zhvillohen përmes prezantimeve në grup. Kjo formë nxit përgjegjësinë dhe rrit respektin e ndërsjellë ndërmjet studentëve, rrit vetëbesimin dhe përgjegjësinë duke i motivuar më shumë ata.</p> <p><b>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</b></p>
<p><b>Shkalla e përbushjes së</b></p>	<p><b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b></p>



standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

### Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin mbi infrastrukturën, por sidomos nga vizita në institucion, GVJ konstaton se procesi teorik i mësimdhënies dhe ai shkencor kryhet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni është zhvendosur në ambiente të rikonstruara që kanë transformuar cilësisht mjediset e mësimdhënies dhe të stafit administrativ.</p> <p>Universiteti European i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Rruga “Xhanfize Keko”, Nd. 56, Tiranë. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m<sup>2</sup>. UET ka në dispozicion 3 godina ku zhvillohet procesi akademik dhe 4 godina me ambiente teknike shërbimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Godina A është e përbërë nga 4 kate, me sipërfaqe 3596 m<sup>2</sup>. Në këtë godinë, ndodhet Salla Aula Magna me një sipërfaqe rreth 110 m<sup>2</sup>, me një kapacitet akomodues prej 70 vende. Ambienti është i pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video.</li> <li>- Godina B është e përbërë nga 4 kate, me sipërfaqe 2306 m<sup>2</sup>.</li> <li>- Godina C ku janë strehuar palestra dhe laboratorët e arteve, me sipërfaqe 444.8 m<sup>2</sup>.</li> </ul> <p>Një ekip me teknikë është i punësuar, që përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambjenteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, mirëmbajtjen e mjediseve mësimore.</p> <p>Normativat teknike të ndriçimit natyral janë konform kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Mjediset e brendshme të mësimdhënies janë të pastra, higjenike dhe të pajisura me teknologjinë më të fundit e cila garanton standarte të larta e bashkëkohore mësimdhënie.</p> <p><u>Mjediset, sallat sportive, palestrat, paisjet me setet bashkëkohore sportive brenda mjediseve të UET janë në hapat e para dhe ka ende shumë punë dhe nevoja investimesh serioze për të ardhmen, ndonëse departamenti ka marrëveshje ndërinstitucionale kontraktuale që mundësojnë zhvillimin e praktikave sportive.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta.</b></p> <p><b>Evidenca 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e reja konstatohet se UET ka aktualisht në përdorim 45 salla mësimore, (17 salla laboratorë- 410 vende total, 13 salla për seminare- 353 vende dhe 15 salla leksioni – 1138 vende). Janë në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>përdorim dhe funksion salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m<sup>2</sup> dhe 1138 vende dhe salla seminari gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m<sup>2</sup>, dhe 353 vende, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p> <p>Sallat për leksionet dhe seminarat janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni.</p> <p>Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëaret përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor.</p> <p>Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëbin. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>GVJ konstaton se kanë filluar përpjekjet e para që UET edhe për këtë program studimi të investojë për ambientet e veta sportive.</p> <p>Sigurisht që UET ka marrëveshje kontraktuale me palë të treat për realizimin e procesit mësimor të praktikave sportive, por mendojmë që vetë UET duhet të investojë në këtë drejtim.</p> <p>Ky kriter plotësohet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta.</b></p> <p><b>Evidenca 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në UET stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrain; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj.</p> <p>UET i pajis studentët dhe stafin me emaile zyrtare etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me Universitetin. Gjithashtu, përmes sistemit të menaxhimit të të mësuarit Moodle (UET LMS), çdo pedagog mund të hapë një llogari lënde nga e cila pedagogu ndan shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose esse-të dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>Kampusi ka akses në internet në të gjitha ndërtesat dhe laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me programet më të fundit windows. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike në UET bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.</p> <p><b>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</b></p> <p><b>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p> <p><b>Evidenca 46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Evidenca 46.3. UET LMS Guidë për studentët.</b></p> <p><b>Evidenca 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAM SLMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e UET konstatuam se institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>ndihmëse në ambientet e bibliotekës së tij.</p> <p>Literatura është bashkëkohore e pesë viteve të fundit nga fondi leading books dhe pasqyrohet në programet dhe syllabet e lëndëve. Literatura u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Biblioteka është e vendosur në Godinën A, salla për bibliotekën me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>, dhe një salle leximi 50m<sup>2</sup> me 41 vende leximi. Gjithashtu edhe një ambient me sipërfaqe 300m<sup>2</sup> në një godinë tjetër ku ndodhet fondi i librave të bibliotekës. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online SAGE dhe EBSCO, në të cilat është abonuar institucioni.</p> <p>Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. UET ka gjithashtu akses në një numër të konsiderueshëm bibliotekash on-line sic janë; 1.Edward Elgar Publishing 2. ASTM Compass 3. Sage 4. Ebsco etj.</p> <p><b>Evidenca 45. Inventari i teksteve në fushën e programit (Sporte).</b>  <b>Evidenca 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b>  <b>Evidenca 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka në UET ka një fond librash shumë të pasur (prej rreth 7210 titujsh dhe 2739 janë në proces për t'u regjistruar në katalogun tonë online) për secilin nga programet e studimit të ofruar nga UET. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ka në dispozicion 2387 tituj. UET ofron ambiente komode për lexim dhe salla studimi për më shumë se 41 studentë dhe pedagogë.</p> <p>Titujt e librave vlerësohen si të mjaftueshëm për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte". Biblioteka pasurohet çdo vit.</p> <p>Librat e bibliotekës janë të inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: anglisht, shqip, frëngjisht etj. Librat blihen dhe përzgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesave, humbjes apo dëmtimin e librave.</p> <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Evidenca 45. Inventari i teksteve në fushën e programit (Sporte).</b>  <b>Evidenca 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</b>  <b>Evidenca 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë.</b>  <b>Evidenca 45.3. Shembull procedure blerje literature.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të</p>	<p>Universiteti "Barleti" ka anëtarësim të plotë në SAGE dhe EBSCO.</p> <p>Burime online janë 4 platformat:</p> <p>1. Edëard Elgar Publishing 2. ASTM Compass 3. Sage 4. Ebsco</p> <p>UET është në proces aprovimi të lidhjes me këto 5 platforma elektronike të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>përafërta me programin e studimit.</p>	<p>reja:</p> <p>1. Edward Elgar Publishing 2, 2. ASTM Compass 2, 3. IOP Science 4. IOP Science 2, 5. Hein Online's Social Justice Suite</p> <p>Drejtuesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Studentët apo stafi akademik, përmes llogarisë personale që ka secili, mund të hyjë në platformë, dhe mund të rezervojnë ose në mungesë mund të bëjnë kërkesë për rezervimin e librave sapo të kthehet në bibliotekë. Platforma është plotësisht e automatizuar dhe i gjithë ky proces ndiqet dhe menaxhohet lehtësisht nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike.</p> <p>Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS - (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore.</p> <p><b>Evidenca 46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Evidenca 46.3. UET LMS Guidë për studentët.</b></p> <p><b>Evidenca 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET ka rritur fokusimin dhe investimet në infrastrukturë ndaj aktualisht ai zotëron një bazë laboratorike moderne dhe cilësore. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike.</p> <p>Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet/software e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor.</p> <p>Ne si GJVJ sugjerojmë që në të ardhmen të mendohet për laboratorë të matjes të cilësive fizike apo parametrave fizike në mënyrë që të përdoren jo vetëm nga studentët e ciklit të dytë por dhe të tretë të studimit.</p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p><b>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta.</b></p> <p><b>Evidenca 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët në UET përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrain; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj.</p> <p>UET i pajis studentët dhe stafin me emaille zyrtare etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me Universitetin. Gjithashtu, përmes sistemit të menaxhimit të të mësuarit Moodle (UET LMS), çdo pedagog mund të hapë një llogari lënde nga e cila pedagogu ndan shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose esse-të dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>Platformat online të mësimdhënies (e-learning), UET LMS dhe Microsoft</p>



	<p>Teams, janë përdorur masivisht gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, në kushtet e pandemisë botërore Covid-19. Në këtë kuadër janë kryer dhe trajnime nga Zyra e IT në UET për zhvillimin e procesit mësimor në platformat online Microsoft Teams dhe LMS.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Vendim Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19.</b></p> <p><b>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p> <p><b>Evidenca 46.2. UET LMS Guidë për pedagogun.</b></p> <p><b>Evidenca 46.3. UET LMS Guidë për studentët.</b></p> <p><b>Evidenca 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</b></p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga vizita në UET si dhe nga shqyrtimi i infrastrukturës në funksion të programit të studimit, GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të brendshëm të komunikimit si p.sh.adresat elektronike të UET, shkëmbimi i dokumenteve përmes UET LMS etj.</p> <p>Transparenca në tërë proceset akademike realizohet përmes paraqitjes në Intranet (Dokumenta UET) të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, legjislacionin përkatës, urdhërat e Rektoratit të UET-it, etj.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Vendim Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19.</b></p> <p><b>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</b></p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në fillim të muajit tetor të vitit të tretë, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të punës për të konsultuar tematikat e ndryshme që mund të shërbejnë si object studimi në nivel diplome, si dhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Secili student që ka të drejtë të marrë temën e diplomës bazuar në kriteret e notës mesatare të përcaktuara nga rregulloret e brendëshme të IAL-së, propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit bazuar në disiplinën apo ekspertizën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës.</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku ai është i gatshëm për ti udhëhequr.</p> <p>Brenda javës së pestë të semestrit të pestë, studentët pajisen nga Departamenti me formularin e aplikimit për temën e diplomës.</p> <p>Pas caktimit të mbikëqyrësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me zgjedhjen e temës deri në përfundimin e punimit të diplomës.</p> <p><b>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p><b>X</b></p>	
<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cila promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.</b></p>			
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional</p>	<p>Nëse i referohemi Statutit të UET në Nenin 11 – Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë dhe Nenin 16 – Komisioni i Sigurimit të</p>		



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Brendshëm të Cilësisë thuhet se: UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. SBC është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET. SBC realizohet nëpërmjet strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë autonome, e përhershme. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapësirën Europiane të sigurimit të cilësisë</li> <li>- Legjislacionin në fuqi.</li> </ul> <p>Në fund të cdo semestri apo para sezonit të provimeve, ai organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi.</p> <p><b>Evidenca 2. Statuti UET.</b>  <b>Evidenca 30.1. Plani veprimtari KSBC.</b>  <b>Evidenca 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b>  <b>Evidenca 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së funksionimit të programit të studimit GVJ konstaton që Njësia Kryesore ka ngarkuar Departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve si përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Departamenti është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, kryen aktivitetet mësimdhënës e shkencor, si dhe shërbime administrative.</p> <p>Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit.</p> <p>Mbledhjet e zakonshme të Departamentit zhvillohen një ditë të caktuar të javës (cdo të martë ora 16.00-18.00) ku 1 mbledhje në muaj duhet të jetë e hapur edhe për studentët.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët janë të vetëdijshëm që janë të përfshirë në një proces vlerësimi gjatë gjithë vitit akademik dhe posaçërisht për aspektet e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve - si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” si dhe për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve ppt, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika sportive, aplikime studimore,</p>



	<p>ndërveprimet me të ftuar nga fushat e aktivitetit fizik dhe sportit që vizitojnë kampusin, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.</p> <p>Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë për çdo temë metoda pedagogjike që do të përdoret në mësimdhënie.</p> <p><b>Evidenca 19.1 Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe i dytë.</b> <b>Evidenca 30.1. Plani veprimt KSBC.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, si dhe pas shqyrtimit të CV-ve të tyre, GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës përfaqësohen në projekte shkencore, projekte profesionale, seminare, ëorkshop-e në fushat përkatëse të kërkimit shkencor etj.</p> <p>Në bashkëpunim me “Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit” ofrohen trajnime 1-ditore ose më gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti.</p> <p><u>Shumë e rëndësishme nga ana e GVJ-së konsiderohet kualifikimi i stafit akademik MSc të cilët duhet të jenë më aktiv në studime shkencore, referime apo botime si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</u> UET dhe Fakulteti në bashkëpunim me departamentin duhet të mendojnë seriozisht për konferencën e tyre shkencore e cila do të ishte një mundësi shumë e mirë sidomos për pedagogët e rinj dhe studentët që pikasen se kanë të ardhme akademike.</p> <p>Ky kriter përmbushet pjesërisht.</p> <p><b>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.</b> <b>Evidenca 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjatë vizitave dhe bisedave me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë konstatohet që Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizojnë në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga trajnues kombëtarë e ndërkombëtarë, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit.</p> <p>UET në përputhje dhe me planin e tij strategjik ka krijuar e po krijon hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave akademike dhe instituteve në përbërje të tij.</p> <p>Për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja UET shfrytëzon dhe periudhat e shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmust KAII si dhe trajnimet e herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera).</p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b> <b>Evidenca 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe</p>	<p>Bazuar në Statutin e UET si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të</p>





<p>personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Institucionit dhe të Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, stafi akademik i programit të studimit si dhe stafi ndihmës akademik (Koordinatori i Programit të Studimit, etj.) janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe gjykojmë se janë realisht të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim.</p> <p>Vlen të theksohet që në kushtet e krijuara nga situata e pandemisë Covid-19, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, pa përjashtim i gjithë stafi akademik ka qenë i angazhuar në mësimdhënie online në platformat e-learning pavarësisht kategorive të ndryshme të moshave brenda stafeve akademike kur duket sikur teknologjitë e reja janë attribute të brezave të rinj.</p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS.</b></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimeve me stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore.</p> <p>Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse.</p> <p>Personeli akademik ka lirinë akademike e profesionale të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. Vlen të theksohet që stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.</p> <p><b>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS.</b></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
		<b>X</b>	

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen</p>	<p>UET i pajis studentët me udhëzuesin e studentëve, i cili informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen e zyrtare të Universitetit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



nga studentët.	<p>Në pikën 5 të rregullores së programit të studimit - Kontrolli i dijeve të fituara nga studentët; 5.1 Sistemi i vlerësimit; thuhet: Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me gërma nga F në A, sipas tabelës përkatëse. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese.</p> <p>Në pikën 5.2 Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijes thuhet:</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <p>- <u>Për lëndët e Tipologjisë I</u></p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%)</p> <p>b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)</p> <p>- <u>Për lëndët e Tipologjisë II</u></p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%)</p> <p>b. Provimit të ndërmjetëm (30%)</p> <p>c. Detyrë kursil (20%)</p> <p>d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%).</p> <p>- Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Provimet janë pa pagesë.</p> <p>- Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Rregullorja akademike, rregullorja e programit dhe silabusi i lëndës njoftohen për të gjithë studentët në fillim të çdo viti akademik dhe shpjegohen për çdo rast në varësi të kërkesave gjatë vitit akademik.</p> <p><b>7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b></p> <p><b>7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të fillimit të cdo lëndë, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë,</li> <li>- objektivat e lëndës,</li> <li>- rezultatet e të nxënit të lëndës,</li> <li>- literaturën bazë dhe të rekomanduar dhe</li> <li>- materialet e tjera të lëndës,</li> <li>- metodën e vlerësimit të lëndës,</li> <li>- shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</li> </ul> <p>Vlerësimi i lëndës përcaktohet apo është në varësi të tipologjisë së lëndës. Njoftime për provimet dhe vlerësimet vendosen edhe në platformën LMS. Kontakte të vazhdueshme me email me studentët mban edhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Pergjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve.</p>



	<b>7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b> <b>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve.</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve në programin studimor Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, si dhe pas takimit me studentët, konstatohet se njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: - Për lëndët e Tipologjisë I parashikohet zhvillimi i 2 detyrave praktike në semestër: a. Lloji i detyrave praktike të planifikuara (produkt i pjesshëm i një projekti / performancë artistike / raport eksperimenti / rast studimor, etj) përcaktohet në programin e lëndës. b. Vlerësimi i studentit bëhet me pikë (maksimumi 30 pikë). - Për lëndët e Tipologjisë II: a. Temat e detyrës së kursit (esesë / komentarit të tekstit / detyrës së grupit), u vihen në dispozicion studentëve, brenda javës së 6-të (të gjashtë) të semestrit. Vlerësimi përmblendhës realizohet me test përmblendhës në fund të vitit akademik. Ky kriter përmbushet plotësisht. <b>Evidenca 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Vlerësimi i një lënde apo nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme: a. Provimi i ndërmjetëm b. Niveli i diskutimit në seminare c. Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte) dy detyra praktike d. Provimi përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri F. <b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b> <b>7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion konstatohet që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në regjistrin përkatës elektronik. Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet,

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>praktikat sipas përcaktimeve edhe në Rregulloren për funksionimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Në pikën E.I.8.6 Provimet thuhet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretaria përgatit listën emërore të studentëve që hyjnë në provim për seicilën lëndë, të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm.</li> <li>- Merr në dorëzim nga pedagogu i lëndës provimet e korigjuara duke mbajtur shënim datën e dorëzimit dhe numrin e tezave të dorëzuara, pas ii numëron ato së bashku me pedagogun e lëndës.</li> </ul> <p>Në projektet për të ardhmen në UET parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies.</p> <p>GVJ sugjeron që UET si pjesë e programit CleanScore duhet të kalojë drejt korigjimit 100% të testeve elektronikisht gjë e cila jep dy mundësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- korigjimin në kohë rekord dhe pa kontestime</li> <li>- ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me notë.</li> </ul> <p><b>Evidenca 5.1. Vendim Mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.</b></p> <p><b>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” konstatohet se vlerësimi me komision në UET është i detyrueshëm vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për detyrimet si praktika profesionale dhe</li> <li>- punimi i diplomës / provimi i përgjithshëm përfundimtar.</li> </ul> <p>Provimet e lëndëve janë në kompetencë të pedagogut të lëndës nëse i vlerëson vetëm apo me asistentin e tij.</p> <p>Është e drejta e studentit që nëse është i paqartë ose ka pakënaqësi për vlerësimin nga ana e pedagogut apo komisionit, të ankohet me shkrim për notën në lëndën në afat prej tri (3) ditësh nga data e komunikimit të notës pas përfundimit të lëndës, por para shënimit të notës në rregjistrin e arritjeve akademike.</p> <p>Ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t’i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b></p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet kodifikimi apo sekretimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga dy pedagogë të emëruar nga departamenti, dhe një sistem kamerash sigurie të cilat sigurojnë fakte konkrete në raste të vecanta parregullsie (sipas rregullores së provimeve në fuqi).</p> <p>Kodifikimi para provimit dhe dekodimi i tezave bëhet nga sekretaria mësimore.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b></p> <p><b>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet</p>	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësiwe të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në detyra kursi, projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi ku evidentohen pikat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>e forta dhe të dobta dhe jepen rekomandimet përkatëse sesi ato mundet të përmirësohen.</p> <p>Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv nga ana e tyre mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogëve si mundësi konkrete që ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Pedagogu në tezën e provimit ka edhe seksionin e komenteve për pyetjet me alternativa.</p> <p>Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit.</p> <p><b>Evidenca 7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>UET, nëpërmjet rregullore mbi disiplinën e studentëve, merr të gjitha masat që sallat e provimeve të jenë të monitoruara, pa praninë e celularëve dhe të librave apo evidencave studentore në tavolinën e provimit si dhe dënon kopjen dhe plagjiaturën.</p> <p>Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Përveç rregullore së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmbyllëse.</p> <p>Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese gjatë vitit. Nëse kopjimi apo plagjiatura përsëritet 3 herë studenti përjashtohet nga universiteti.</p> <p>Gjithashtu, UET që prej vitit 2015, implementon sistemin anti plagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson kontrollin dhe vlerësimin e pastërtisë dhe origjinalitetit të cdo punimi përpara vlerësimit përfundimtar.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET. Neni 33, Plagjiatura dhe kopjimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentacionin dhe evidencat e shqyrtuara afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i grup lëndës përpara shumëfishimit për provim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brënda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre.</li> <li>- Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë.</li> </ul> <p>Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, pas periudhës së provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në bazë të meritës.</p> <p>Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET. Neni 27, Provimet.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullore së programit të studimit si dhe nga vizita ne universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u njohur me vlerësimin si dhe për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në sekretarinë mësimore me anë të një formulari të veçantë, menjëherë pas shpalljes së notave përfundimtare por para shënimit të notës në Regjistrin e arritjeve akademike.</p>



	<p>Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (LMS dhe UMIS). Brenda dy javëve nga realizimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe / ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin.</p> <p>Pas sqarimit dhe konkludimit dypalësh student - pedagogu i lëndës, ky i fundit plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b> <b>Pika 5.3.4</b></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Në rastet kur pedagogu refuzon ndryshimin pas ankimit të studentit, studentit bën një ankimim dhe ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision prej 3 vetësh për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet në sekretarinë mësimore.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b> <b>Pika 5.8, Kërkesa për rivlerësim.</b> <b>Evidenca 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përbushjes së plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>


**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, për ata studentë që kanë rezultatet më të larta dhe kanë synime për më lart.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet punëve të pavarura dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, aktivitete të larmishme studentore etj.</p> <p>GVJ nga takimet me studentët konstatoi vëmëndjen e institucionit sidomos për studentët e spikatur në sport sepse vërtet ata janë elemente të fuqishme marketingu për institucionin.</p>





	<p><b>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton se 18 ECTS ose 10% e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është e përbërë nga lëndë të tipit D, 36 ECTS ose 20% e programit janë të tipit A, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Programi përmban lëndë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje në filozofi,</li> <li>- Shkrim Akademik,</li> <li>- Mjekësi sportive, rehabilitim,</li> <li>- Gjuhë angleze,</li> <li>- Bazat e informatikës,</li> <li>- Hartim dhe menaxhim projektsh,</li> <li>- Praktikë dhe zhvillim karriere.</li> </ul> <p><b>Evidenca 14. Kurrikula e programit BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b>  <b>Evidenca 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Edukim Fizik dhe Sporte (Aneks Tabela 9).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde përmblihen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde dhe merret dhe mendimi i studentit për përmirësime në të ardhmen.</p> <p>Në analizat e departamentit është praktikë e zakonshme pune që të shqyrtohet gjerësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve,</li> <li>- sfidat në arritjen e tyre,</li> <li>- efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie,</li> <li>- përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë.</li> </ul> <p>Një mënyrë për të shqyrtuar se çfarë studentët kanë kuptuar përpara se të mbyllin kursin, janë edhe esetë detyrat e kursit që realizojnë javën e 13-të të semestrit akademik.</p> <p><b>Evidenca 38. Analiza e departamentit Ba Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se leksionet zhvillohen kryesisht duke kombinuar prezantimet interaktive ppt me metodën tradicionale të shkrimit në tabelë. Këto shënime dhe përmbledhje leksionesh ndahen më studentët javë pas javë.</p> <p>Me përfundimin e lëndës pedagogu përgjegjës jep një pasqyrë të saktë mbi formatin mbi të cilën do të ndërtohet provimi përfundimtar. Studentët para këtij provimi kanë zhvilluar provimin e ndërmjetëm pra janë njohur me strukturën e provimit pasi provimi përfundimtar ka të njëjtën strukturë dhe format.</p> <p>Kjo mundëson që studentët janë të qartësuar me gjithshka ka lidhje me provimin e ndërmjetëm apo përfundimtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- llojin dhe numrin e pyetjeve,</li> </ul>







	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe</li> <li>- pjesët e programit që përfaqësojnë,</li> <li>- kohën e testit dhe</li> <li>- mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve.</li> </ul> <p>Pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET.</b>  <b>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve.</b>  <b>Evidenca 41. G-I-12-1 Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope mbi të rejat e fundit në fushat e tyre të ekspertizës, si dhe zhvillon leksione në institucione të ndryshme.</p> <p>Stafi akademik kryesisht ai me tituj e grada zhvillon inovacione të hapura duke zhfrytëzuar lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë.</p> <p>Leksionet e hapura zhvillohen nga ekspertë të fushës vendas apo të huaj dhe këto leksione zhvillohen si në kuadër të lëndëve të caktuara të programit të studimit, ashtu edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik.</p> <p><b>Evidenca 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH).</b>  <b>Evidenca 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në UET realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor "Edukim Fizik dhe Sporte" kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, ato të statistikës, gjuhës së huaj, si dhe në praktikant profesionale.</p> <p>Praktikat profesionale dhe ato sportive parashikojnë të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional.</p> <p>Studentët e programit të studimit Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte e zhvillojnë praktikën profesionale sipas profilit në institucione sportive gjë e cila i shërben familjarizimit të tyre me tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</b>  <b>Evidenca 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti).</b>  <b>Evidenca 33. Trajnime të mëtejshme profesionale.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ konstaton se diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte".</p> <p>Gjatë orëve të seminarit apo detyrave të kursit, pedagogët mund të japin raste studimore, për interpretimin dhe zgjidhjen e të cilave angazhon studentët në punë në grupe prej 2-3 vetësh.</p> <p>Nëpërmjet punës në grup apo fokus grupeve UET synon të zhvillojë aftësi të tilla, si: arsyetimi, zgjidhja e problemeve, mbajtja e</p>



	<p>qëndrimeve; aftësi interpersonale si: të dëgjuarit, të folurit, bashkëbisedimi, drejtimi pra kultivojnë cilësitë e dinamikës së grupit.</p> <p><b>Evidenca 14.1. Plani mësimor i programit - BA Edukim Fizik dhe Sporte.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga vizita në UET konstatuam se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte; të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre të thjeshta shkencore në seminare, ëorkshop-e dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Stafi akademik i inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre si mësues të edukimit fizik, por edhe në fushën e akademizmit.</p> <p>Stafi akademik inkurajohet të kryejë studime që lidhen me lëndët që zhvillon, dhe t'i përfshijë publikimet në literaturën e syllabusit të lëndës, për t'i trajtuar gjetjet edhe me studentët gjatë orëve të seminarit. UET ndjek politikat e financimit dhe stimulimit financiar për stafet akademike që publikojnë në revista të indeksuara apo me faktor impakti gjë e cila ndikon edhe në rritjen e rankimit më lart në nivel kombëtar e ndërkombëtar të UET-së.</p> <p><b>Evidenca 28.1. Projektet UET_2014-2020.</b></p> <p><b>Evidenca 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ konstaton pas takimit me studentët se ata inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht nëse veprimtaria e tyre vlerësohet si inovacion dhe risi për ciklin e tyre të studimit.</p> <p>Në Strategjinë e kërkimit shkencor UET 2021-2025 theksohet: UET do të ndërtojë dhe përmirësojë në vazhdimësi një infrastrukturë të kërkimit shkencor, për ti dhënë frymëmarrjen e duhur punës studimore të stafit akademik. Ai synon transferimin e arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjen e tyre në veprimtari kërkimore.</p> <p><b>Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025.</b></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. UET ka marrëveshje bashkëpunimi me 94 IAL të huaja, me 15 IAL vendase, me 20 institucione të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare si partnerë/donator etj.</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë Edukimit dhe Sporteve duhet të krijojë kontaktet dhe network-un e vet në mënyrë që edhe studentët e programeve të studimit të sporteve të fillojnë me mobilitetet në universitetet partnere kryesisht në Europë.</p> <p>Fakti që në dokumentacion theksohet se asnjë student i këtij programi studimi nuk ka realizuar mobilitet në kuadër të Erasmus + tregon që departamenti ka shumë punë përpara, <u>ndonëse GVJ merr seriozisht në konsideratë që kemi të bëjmë me një program të ri studimi dhe pandemia ka kufizuar ndjeshëm krijimin e partneriteteve të reja.</u></p> <p>Ky kriter përmbushet pjesërisht.</p> <p><b>Evidenca 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve</b></p>



	<p><i>dhe mobilitetin.</i></p> <p><i>Evidenca 28.1. Projektet UET_2014-2020.</i></p> <p><i>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre – Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura për provimin final para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p>UET ka hartuar udhëzuesin e provës finale ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Temë diplome bëjnë vetëm ata studentë me notë mesatare së paku 8.5 dhe që bëjnë kërkesë me shkrim.</p> <p>Kjo paketë udhëzimesh përmban të gjitha elementet për procedurat e përgatitjes, të konsultimeve, të monitorimit, të vlerësimit të punës trevjecare; përmban përgjegjësitë e seicilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të programit të studimit.</p> <p>Për të fituar diplomën Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studenti duhet të ketë marrë 180 kredite dhe të marrë provën finale që realizohet me provim final apo mbrojtjen e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</i></p> <p><i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Çdo informacion dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në UET është i publikuar dhe i aksesueshëm për të gjithë studentët. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një fond pyetjesh nga disiplinat kryesore të programit të studimit për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe shpallen jo më vonë se data 31 Mars të semestrit të gjashtë, si dhe për projektin e diplomimit.</p> <p>Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përziejdhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Gjithashtu për departamentin është shumë e rëndësishme puna paraprake me studentët, konsultimi i pyetjeve dhe takimet sqaruese me titullarët e lëndëve përpara provimit të përgjithshëm përfundimtar apo provimit final dhe konsultat metodologjike për mbrojtjen e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi final në UET është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre master shkencor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Nga viti akademik 2019-2020 pësha do të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C. Pyetjet janë cilësore dhe forma e zgjidhjes së tyre është me zhvillim e cila teston realisht nivelin e përgatitjes dhe formimit të studentit.</p> <p>Komisioni i Departamentit përgatit provimin final bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p><b>Evidenca 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</b>  <b>Evidenca 7.2. Format i tezës së provimit perfundimtar.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave dhe evidencave GVJ konstaton se në UET për të fituar diplomën e studimeve Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t’i nënshtrohen edhe provës finale (provim formimi) apo ata me mesatare mbi 8.5 me mbrojtje diplome nëse e kërkojnë.</p> <p>Pedagogët japin udhëzime dhe bëjnë konsultime me studentët për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Secila palë mban përgjegjësitë që përfshihen në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të ciklit të studimeve bachelor.</p> <p>Komisioni që ngrihet për vlerësimin e studentëve në provimin final apo mbrojtjes së temës së diplomës të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, bazohet në procedurat e përshkruara hollësisht të paketën e provës finale.</p> <p><b>Evidenca 7.2. Format i tezës së provimit perfundimtar.</b>  <b>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>UET ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme ndonëse temat e diplomave në bachelor janë kryesisht të karakterit teoriko empirik apo përmbledhje literature.</p> <p>Pedagogu udhëheqës mban kontakte të vazhdueshme me studentin diplomant gjatë javës dhe e asiston edhe në mjediset sportive për realizimin e pyetësorëve apo testeve ku në këtë rast një ndihmë e madhe është edhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetësorët e tyre, tek studentët e tjerë në UET nëpërmjet koordinatoreve ose me anë të paisjes me një vërtetim zyrtar i mundëson studentit mbledhjen e të dhënave edhe jashtë UET-së.</p> <p><b>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas</p>	<p>Udhëheqësi i temës së diplomës është i angazhuar totalisht në mënyrë që studentit të zbatohet me përpikmëri templates të punimit të diplomës, metodologjinë e kërkimit, përpunimet statistikore, ndihmon për zbatimin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>e grafikut të punës në terren, planifikimin, implementimin analizimin e të dhënave dhe është prezent në përmbylljen e punimit komform të gjitha kërkesave dhe kritereve të vendosura në UET. Ai merr seriozisht plagjiaturën dhe vetëm pasi miratohet nga udhëheqësi i temës, punimi i diplomës është gati për të filluar procedurat e mbrojtjes.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET. Neni 39, Mbrojtja e diplomës.</b>  <b>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i vlerësimit të temës së diplomës përbëhet nga 3 pedagogë ose specialistë të fushës. Ata duhet të jenë me tituj dhe grada.</p> <p>Për vlerësimin e diplomës anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh disa kritere si demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit); cilësinë e prezantimit etj.</p> <p>Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET. Neni 39, Mbrojtja e diplomës.</b>  <b>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS dhe provimin final apo mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin.</p> <p>Zyra e Regjistrimit të Universitetit pajis studentët e diplomuar me diplomën brenda 6 (gjashtë) muajve. Deri në momentin e pajisjes me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën dhe suplementin e diplomës të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm, sipas formateve të licënuara dhe të aprovuara nga MAS në përputhje me aktet rregulluese dhe është rregjistruar pranë QSHA. Vetë diploma firmoset nga Rektori dhe Dekani.</p> <p><b>Evidenca 5. Rregullore e UET. Neni 40, 41.</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentët mund ta aksesojnë programin e zhvilluar në çdo moment, nëpërmjet sistemit interaktiv. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të zhvilluar Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p><b>Evidenca 15.1 – 15.5 Modele Diplome_Suplement - BA EFS.</b></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse</p>	<p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij</p>



kërkohen.	të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. informacionit dhe paisjen e me informacionin e Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore mësimore Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë vlerësimit të situatës në terren, pamë që zyra e burimeve njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson në çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programet e studimit, si ata me kohë të plotë, ashtu edhe personelin me kohë të pjeshme. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, në çdo semestër dhe vit akademik <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore.</i> <i>Format staf akademik, ref.44/1, 44/2.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka hartuar bazë ligjore dhe nënligjore për rekrutimin e personelit të brendshëm dhe të jashtëm akademik, e mbështetur dhe në rregullore të brendshme. GVJ e pa në terren dhe e gjen të mbështetur plotësisht procedurën e ndjekur. <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr. 11</i> <i>Shembull thirrje per staf akademik, ref. 11/1</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Nevoja për tu plotësuar me staf akademik, ndjek rrugën ligjore, e pasqyruar qartësisht në faqen zyrtare të universitetit dhe mbështetur në kriterin e transparencës që ndjek institucioni me anë të konkursit. <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr. 11</i> <i>Faqja Zyrtare UET.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë	Një rregullore e brendshme e hartuar për këtë qëllim, ndihmon në rekrutimin e stafit akademik, por edhe mëtej, në plotësimin e detyrave që duhet të plotësojë në vijimësi, në shërbim të punës në institucion, personi i rekrutuar rishtazi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<b>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr.11</b> <b>Faqja Zyrtare UET.</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Mjediset e punës gjatë vëzhgimit në terren, janë mjaftueshëm të përshtatshme, për të siguruar barazi dhe lehtësim në përmbushjen e detyrave të personelit akademik. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Ka një angazhim serioz të institucionit në fjalë, lidhur me rritjen profesionale e shkencore të personelit, përmes programeve si ERASMUS +, lidhjes me rrjetet europiane universitare, mbështetje financiare për profesoratin etj. <i>Qendra e metodologjisë dhe kërkimit °145</i> <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr.11</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Qendra metodologjike e kërkimit si dhe njësi të interesuara, organizojnë trajnime afatshkurtëra një ose disa ditore, në vazhdimësi dhe që rrisin aftësitë e stafit akademik, në fushën e kërkimit shkencor dhe rritjes profesionale dhe botimeve. <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr.11</i> <i>Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 dhe 2020-2021, (ref.nr.3/1, ref.nr.3/2)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Shpërndarja e lëndëve në bazë të ekspertizës, kujdesi institucional për rritjen e cilësisë së përgatitjes së studentëve bachelor dhe realizimin e objektivave, dëshmon seriozitet. <i>Dokumenti G, rregullore për burimet njerëzore, ref nr.11</i> <i>Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 dhe 2020-2021, (ref.nr.3/1, ref.nr.3/2)</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
-----------------	-------------------------------	--	--

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Siperfaqja totale e ambienteve të brendshme është 5755 m<sup>2</sup>, njëherazi, mjediset e brendshme, krahasuar me numrin e studentëve, janë funksionale. Janë në tërësi 15 salla, nga të cilat 13 salla në funksion të veprimtarisë akademike, me sipërfaqe totale 1447 m<sup>2</sup> dhe 1138 vende të ulura. Janë 13 salla seminari me 353 vende. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni ka rreth 17 laboratore informatike si dhe një sallë 70 vendëshe informatike. Është instaluar dhe është funksional sistemi MOODLLE (UET, LMS) që mundëson komunikimin online midis stafit akademik dhe studentëve. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1</i> <i>Video trajnime për sistemin TEAMS/LMS ref.46/4.</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat janë pajisur me Pc, projektorë, foni, internet si dhe numri i sallave të pajisura me teknologji digjitale shkon rreth 9. Kjo lehtëson aftësimin teorik të studentëve. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1.</i> <i>Video trajnime për sistemin TEAMS/LMS ref.46/4.</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Janë rreth shtatë laboratore informatike, të mirëpajisur me aksesorë, të cilët lehtësojnë stafet pedagogjike dhe vetë studentët në ushtrimin e detyrave teorike. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1.</i> <i>Video trajnime për sistemin TEAMS/LMS ref.46/4.</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Ka marrëveshje me institucione të tjera, lidhur me mundësinë që u ofrohet studentëve në përmbushjen e objektivave praktike mësimore, sikundër janë praktikat profesionale në klasa, në shkolla, në terrene sportive etj. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, ref 42&amp;42/1.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<b>X</b>	

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka në përdorim një bibliotekë me rreth 35 m<sup>2</sup> sipërfaqe, ku marrin shërbim edhe studentët bachelor në edukim fizik dhe sporte. <i>Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës-infrastruktura. (Ref.nr.42 dhe 42/1)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Staf», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ka një fond të kënaqshëm libra, periodike, Cd, harta etj. Literatura fizike pasurohet në vazhdimësi, nëpërmjet porositjeve që bëhen sipas profileve dhe lëndëve. Bëhen porosi në librari elektronike si Sage, Absco etj. <i>Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës-infrastruktura. (Ref.nr.42 dhe 42/1)</i> <i>Dokumenti E-VI-2 Formular për pasurimin e bibliotekës (Ref.nr45.2)</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Abonimet në Sage, Absco, Questia janë një mundësi konkrete për përmbushjen e misionit të realizimit sa më cilësor të programit të studimit, shto edhe PC si dhe ËI-FI. <i>Aneks: Tabelat përmbledhese - Tabela nr.17: Të dhëna për platformën on-line/strukturat IT/Biblioteka.</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>COBSS.NET, është një rrjet shërbimi për rajonin e Europës jugore, pjesë e të cilit është edhe biblioteka e UET, duke ofruar shërbime cilesore për studentët dhe stafet akademike. <i>Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës-infrastruktura. (Ref.nr.42 dhe 42/1)</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Vume re përpjekje për pasurimin periodik dhe në vazhdimësi të fondit të librit elektronik dhe fizik, në shërbim të studentëve dhe stafeve profesionale. Një plan i detajuar, është hartuar nga institucioni dhe shërben për përditësimin e fondit ekzistues dhe pasurimin e tij në vijimësi <i>Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës-infrastruktura. (Ref.nr.42 dhe 42/1)</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e përdorimit të bibliotekës nga stafet dhe studentët, janë konceptuar nga nevoja për tu ofruar shërbim sa më të plotë dhe të lehtë, veçanërisht gjatë sezonit të provimeve. <i>Aneks: Tabelat përmbledhese - Tabela nr.17: Të dhëna për platformën on-line/strukturat IT/Biblioteka.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.5</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi UMIS, është një investim i institucionit, në shërbim të punëve menaxheriale si, të dhëna personale për çdo student, regjistri i notave, rezultatet e provimeve, rezultatet në vite, financat e studentëve, adresat e tyre etj. (UET; LMS) <i>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<b>Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref.nr.46)</b>		
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	MOODLE ( UET, LMS) është instaluar për t'i shërbyer aspektit menaxherial, ku studenti gjën në kohë reale leksionet e pedagogut, material shtese audio viziv, informim për notat, për axhendat etj.  <b>Moodle (UET; LMS). Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref.nr.46)</b>		
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Duke filluar nga viti akademik 2016-2017, është instaluar sistemi UET LMS, i cili ofron shërbime në lehtësimin menaxherial institucional. Personeli dhe studentët marrin akses të dedikuar në informacion dhe dokumentacion. <b>Moodle (UET; LMS)</b> <b>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></b>		
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi UET LMS, përdoret gjerësisht për komunikimin staf – student, si dhe për krijimin e fondit të të dhënave për çdo student të UET, por edhe për vetë anëtarët e stafit, deri në detaje. <b>Moodle (UET; LMS)</b> <b>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></b>		
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma LMS, në shërbim të KBSC, në bazë të të dhënave të gjeneruara aty, lehtëson komunikimin dhe përdorimin e të dhënave sipas situatave që krijohen. <b>Moodle (UET; LMS)</b> <b>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></b>		
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UET ka konceptuar dhe instaluar një faqe të re në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Faqja zyrtare përmban strukturën, konceptet bazë të funksionimit institucional. Përdorimi i rrjeteve sociale si fb, përdoren gjerësisht në komunikimin institucional.  <b>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi IV.6**  
**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në muajin Tetor të çdo viti akademik, hartohet buxheti nga zyra e financës dhe administratori. Çdo muaj bëhet vlerësimi financiar. Shkëmbimet, pagesat, transaksionet kalojnë në rrugë bankare, duke siguruar kontrollin dhe transparencën. <b>Dokumenti pika E.V. Mbi politikat e prezantimit/promovimit të UET on-line (ref.nr.48)</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafá», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nuk ka financim të përcaktuar për çdo fakultet apo program studimi. Ka një buxhet institucional i cili mbulon të gjitha programet e studimit dhe fakultetet që përfshin UET. Këtu bën pjesë dhe Programi i studimit Bachelor në edukim fizik dhe sporte. Zerat kryesore të financimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Burimet njerëzore,</li> <li>- Shpenzimet operative,</li> <li>- Mirëmbajtje e TIK,</li> <li>- Pasurimi i fondit të bibliotekës etj.</li> </ul> <p><b>Raportet e Auditimit (ref.50-4 dhe 50.6)</b>  <b>Pasqyrat financiare me shenime (ref.50.1dhe 50.3)</b></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësisht financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UET zhvillon auditim të përvitshëm dhe merr konsulencë nga “Deloitte Albania” dhe mbi këtë bazë hartohet një raport transparence financiare institucionale. Mekanizmat e kontrollit, raportojnë në vijimësi gjendjen financiare dhe aftësitë likuiduese të institucionit, nëpërmjet raporteve periodike.</p> <p><b>Raportet e Auditimit (ref.50-4 dhe 50.6)</b>  <b>Pasqyrat financiare me shenime (ref.50.1dhe 50.3)</b></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni ka raport të përvitshëm auditit dhe pasqyrat e transparencës masa të cilat dëshmojnë kujdesin institucional lidhur me shëndetin financiar që nevojitet për vetë UET në përgjithësi, por edhe për mbështetjen e programit të studimit në fjalë i cili ka ende nevojë për financime duke e kthyer atë gradualisht në një program studimi prioritar.</p> <p><b>Raportet e Auditimit (ref.50-4 dhe 50.6)</b>  <b>Pasqyrat financiare me shenime (ref.50.1dhe 50.3)</b></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë mundësinë e institucionit për të garantuar investimin e programit të studimit gjatë viteve të ciklit të tij dhe aftësinë për të gjeneruar të ardhura për vijimësinë e punëve në vitet në vazhdim.</p> <p><b>Raportet e Auditimit (ref.50-4 dhe 50.6)</b>  <b>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-------------------------------------	------------------------------------	---

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)






<b>Standardi V.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Mbështetur në legjislacionin në fuqi, zhvillohet gjithë procedura e rekrutimit të studentëve në bachelor në edukim fizik dhe sporte. Informacioni publikohet online në GUIDA UET. Institucioni ndjek me seriozitet ecurinë e studentit. <i>Politika e marketingut të programit të studimit ( ref.nr.51)</i> <i>Legjislacioni në fuqi, statuti dhe rregulloret përkatëse.</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga hyrja në dalje, procedurat garantojnë transparencë dhe garanci për pjesëmarrësit pa dallim apo preferenca. <i>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></i> <i>Publikimi Online i rezultateve°161</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Përveç Intranetit të UET, kriteret dhe procedurat që zbatohen, janë të arritshme online ose më mirë akoma edhe me prani fizike brenda institucionit. Njëherazi informacioni gjendet edhe në intranet. <i>Publikimi Online i rezultateve°161</i> <i>Faqja zyrtare e UET: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></i> <i>Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve ( ref.nr.27.1)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Numri i studentëve që do të pranohen, propozohet nga departamenti dhe i kalojnë Senatit për miratim. Në bazë të kapaciteteve pritëse, përcaktohet numri i tyre në ciklin e parë të studimeve. <i>Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve ( ref.nr.27.1)</i> <i>Legjislacioni në fuqi, statuti dhe rregulloret përkatëse</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithëshme të pranimit, janë në përshtatje me ligjin e arsimit të lartë, aktet nënligjore dhe të maturës shtetërore. Krijohet hapësirë edhe për student nga trojet apo të huaj.  <i>Ligji arsimit të lartë dhe aktet nën ligjore të maturës shtetërore.</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Ndiquen disa mënyra informimi për të interesuarit, si “gjimnaz tur”, publikime, takime sqaruese në hollin e institucionit etj. <i>Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve ( ref.nr.27.1)</i> <i>Legjislacioni në fuqi, statuti dhe rregulloret përkatëse</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi V.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit,**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>								
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentet informohen qartësisht përmes dy platformave që institucioni i zotëron dhe i vë në dispozicion të të interesuarve, platforma UMS dhe platforma LMS. Studentët që duan të transferojnë studimet në UET, marrin gjithë informacionin e duhur për programin e studimit. <i>Rregullore mesimore. BA. edukim fizik dhe sporte, (ref.nr.17). Moodle (UET; LMS).</i>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Zyra e kujdesit ndaj studentit, në bashkëpunim me departamentin e interesuar, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimin paraprak për studentët e interesuar për transferim të studimeve. <i>Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetit, (ref.nr.28)</i>								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Përdoret “Java Informuese” gjatë së cilës të interesuarit marrin mjaftueshëm informacion dhe zgjidhje. Njihen me mjediset, me rregulloret, me bonuset deri me syllabysset e lëndëve që do zhvillohen vitin e parë. <i>Dokumenti E.V. Politikat e promovimit dhe prezantimit ne UET, on-line (ref.nr.48)</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët e ciklit të parë, edukim fizik dhe sporte, mund të diplomohen nëpërmjet provimit përfundimtar të përgjithshëm ose me mbrojtje diplome, në raste specifike. Institucioni harton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, mbi një metodikë të qartë e vijuese. <i>Dokumenti E.V. Politikat e promovimit dhe prezantimit në UET, on-line (ref.nr.48)</i> <i>Rregullore mesimore. BA. edukim fizik dhe sporte, (ref.nr.17)</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Open Days, Javët e orientimit dhe javët e regjistrimit, janë disa prej formave efektive, për informimin e të interesuarve për tu bërë studentë të ciklit të parë në edukim fizik dhe sporte. <i>UET ON-LINE (Ref,nr48)</i> <i>Dokumenti E.V. Politikat e promovimit dhe prezantimit ne UET, on-line (ref.nr.48)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th><b>Përmbushet pjesërisht</b></th> <th><b>Përmbushet kryesisht</b></th> <th><b>Përmbushet plotësisht</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						
<b>Standardi V.3</b>									
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>									
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>								
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Këshillimi me stafin akademik në institucion. Veprimtaria e zyrës së kujdesit për studentin. Nënshkrimi kontratës në momentin e regjistrimit. <i>Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe proceset e aplikimit të studentëve (ref.nr.27/1)</i>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të	Studentët kanë qasje mbi ngarkesën, temat dhe literaturën nëpërmjet sistemit LMS, por edhe formave të tjera legale, të arritshme si në								

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	aspektin fizik ashtu edhe elektronik.  <i>Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe proceset e aplikimit të studentëve (ref.nr.27/1)</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Gjatë vizitës në institucion, pamë nga afër shembuj punësimi në salla fitnessi, ekupe moshash, në mjedise hoteliere etj. Kontribut kanë edhe vetë pedagogët e departamentit të edukimit fizik dhe sportit <i>Dokumenti E-VII, Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, (ref.nr.12)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët informohen rregullisht dhe me përgjegjësi për çdo problem që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke përdorur me sukses platformën LMS dhe mjetet e komunikimit elektronik.  <i>Politika e marketingut të programit të studimit ( ref.nr.51)</i> <i>Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, ref.nr. 9</i>		
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Paisja nga zyra e IT me një adresë elektronike, u jep mundësi atyre që përveç informimit fizik, të kenë qasje edhe në distancë nëpërmjet sistemit LMS dhe rrjeteve sociale alternative.  <i>Moodle(UET; LMS, UMIS)</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Pamë që institucioni ka një metodikë të mirë mbi numrin e studentëve në hyrje, për gjatë procesit dhe në përfundimin e tij, për çdo program studimi. <i>Dokumenti E.I. Mbi ecurinë e sekretarisë mësimore, ref.nr,9</i> <i>Cilësia në hyrje dhe dalje në BA Edukim fizik dhe sport, ref.nr27</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi UMIS, mundëson që baza e të dhënave të jetë e arritshme në çdo kohë dhe njëherazi regjistron korrektësisht problematikat që shoqërojnë procesin si psh, transferimet, studentët që mbeten pas apo vonohen në arritjen e qëllimeve akademike.  <i>Cilësia në hyrje dhe dalje në BA Edukim fizik dhe sport, ref.nr27</i> <i>Moodle (UET; LMS, UMIS)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Të dhënat gjenden në sekretarinë mësimore dhe zyrën e regjistrimit të studentëve, të cilët kanë dosje të personalizuara dhe të administruara fizikisht dhe në rrugë elektronike. <i>Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



	<i>tyre, ref.nr.29</i> <b>Dokumenti E.I. Mbi ecurinë e sekretarisë mësimore, ref.nr.9</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni siguron dhe mbron të dhënat në gjithë gamën e tyre, nëpërmjet UMIS, program modern i konceptuar posaçërisht për këtë qëllim. <b>Dokumenti E.I. Mbi ecurinë e sekretarisë mësimore, ref.nr.9</b> <b>Moodle (UET; LMS, UMIS)</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i edukimit fizik dhe sportit, harton peridikisht, raport analitik lidhur me profilin dhe cilësinë e hyrjeve dhe daljeve si dhe shkallën e cilësisë së përgatitjes, për të nxjerrë detyra të mëtejshme.  <b>Analiza e departamentit për programin, ref.nr.38</b> <b>Dokumenti E.I. Mbi ecurinë e sekretarisë mësimore, ref.nr.9</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni kënaqshëm mundëson përfshirjen e studentëve në Senat, në Këshillin e Etikës. Mbledhjet e departamenteve janë të hapura për studentët e interesuar. <b>Statuti UET, Neni 16,19 dhe 51, ref.nr.2</b> <b>Rregullore e UET, kreu 7, neni 35, ref.nr.5</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nëpërmjet sistemit LMS, studentët shprehen për pedagogët, programet, etj. Fokus Grupet, janë një tjetër mundësi përfshirje e studentëve në mbarëvajtjen e punëve. Një student psh, është përfshirë në GVB-në, e programit bachelor në edukim fizik dhe sporte.  <b>Statuti UET, Neni 16,19 dhe 51, ref.nr.2</b>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.	Shpërndarja e lëndëve midis semestrave është e ekuilibruar, me rreth 30 kredite në semester. Studentët duhet të përmbushin 30 ECTS për të kaluar në vitin e dytë dhe 90 ECTS për të kaluar në vitin e tretë. Në periudhën e praktikës profesionale, studenti ka lehtësira në program.  <b>Statuti UET, Neni 16,19 dhe 51, ref.nr.2</b> <b>Rregullore e UET, kreu 7, neni 35, ref.nr.5</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të	Përfshirja e studentëve në rishikimin e programeve, arrihet nëpërmjet Fokus Grupeve dhe plotësimin nga ana e studentëve të një pyetësori, që zhvillohet në fund të çdo semestri. Problematikat bëhen objekt diskutimi të hapur.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<i>Statuti UET, Neni 16,19 dhe 51, ref.nr.2</i> <i>UET, Kreu VII, neni 35, ref.nr.5</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Ka përpjekje për barazinë në vlerësimin e dijes. Sekretimi i provimeve, qartësimi nga ana e pedagogut i vlerësimit me notë të merituar, mundësia për rivlerësim e studentit, afrojnë një standart të pranueshëm vlerësimi.  <i>UET, Kreu VII, neni 35, ref.nr.5</i> <i>Statuti UET, Neni 16,19 dhe 51, ref.nr.2</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e kujdesit për studentin është njësi e posaçme në shërbim të studentëve. Këshillimi akademik dhe tutoriati, njëherazi ofrojnë kontributin e tyre modest.  <i>Dokumenti E:VII. Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, ref.nr-12</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyrat administrative, angazhohen dhe kombinojnë në bashkëpunimin mes tyre, në shërbim të këtij qëllimi. Ka përpjekje modeste në këtë drejtim që vjen duke u përmirësuar.  <i>Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik, ref.nr. 27/2</i> <i>Rregullore UET, Neni 24, 27 dhe 32, Ref.nr.5</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e këshillimit të karrierës është në shërbim të gjithëkohshëm të studentëve. Ajo mban lidhje dhe zhvillon komunikim zyrtar me kompani dhe grupe interesi, dhe informon studentët për mundësitë e tregut të punës.  Ne takuam studentë që kishin përfituar mundësi punësimi, me kohë të pjesëshme dhe të plotë, ndihmuar nga institucioni.  <i>Dokumenti E:VII. Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, ref.nr-12</i>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Ka një regjistër të veprimtarisë së zyrës së karrierës, për punësimin e studentëve që janë diplomuar në vite. Funksionon edhe zyra ALUMNI, studentët e përfshirë në të, janë aktivë dhe pjesë e bordeve të tregut të punës pranë departamenteve  <i>Dokumenti E:VII. Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, ref.nr-12</i> <i>Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik, ref.nr. 27/2</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	I kushtohet vëmendje e posaçme, zbatimit me korrektësi të legjislacionit në fushën e arsimit të lartë, me fokus të veçantë sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fuqi, me fokus sigurimin e cilësisë sipas standardeve në të gjitha nivelet. <i>Rregullore e UET, Ref.nr.5, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, ref.nr.8</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	KSBC (këshilli i sigurimit të brendshëm të cilësisë) ka rolin e tij që nga viti 2011 që startoi. Zyra e standardeve të cilësisë (ZSC), është gjithashtu instrument i rëndësishëm që kontribuon për rritjen e cilësisë, duke u harmonizuar me palë të tjera.. Ngritja e organeve këshilluese si Bordet e tregut të punës, përfshirja e ekspertëve të jashtëm etj. <i>Statuti UET, Neni 11&amp; 16, ref.nr.2 Rregullore e UET, Ref.nr.5, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, ref.nr.8</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Përveç KSBC dhe ZSC, që kanë destinacion sigurimin e cilësisë së brendshme, institucioni vlerëson bashkëpunimin me ASCAL, që ndihmon në rritjen e cilësisë së vlerësimit të jashtëm dhe që ka dhënë rezultate dhe veçanërisht me MASR. <i>Ref.nr.5, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, ref.nr.8</i> <i>VBA, nr.12 dt 07.04.2017 për akreditimin periodik të IAL, UET, Ref.nr.54.3-54.4</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	KSBC vepron mbi një plan strategjik dhe mban të informuar në mënyrë periodike, gjithë instancat brenda institucionit, lidhur me raportet e vlerësimit të jashtëm, me qëllim marrjen e hapave konkrete që përmirësojnë cilësinë e brendshme. KSBC, në mënyrë periodike informon drejtuesit e njëjësive dhe stafin për problematikat, me qëllim përmirësimin e tyre në vazhdimësi. <i>VBA, nr.12 dt 07.04.2017 për akreditimin periodik të IAL, UET, Ref.nr.54.3-54.4</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VL2			
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	KSBC ka një rol institucional kyç në sigurimin e cilësisë, posaçërisht në nivelin e parë të studimit, e ndihmuar nga bordet e tregut të punës. Rol të rëndësishëm ka departamenti, si njësi bazë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. <i>Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022, ref. nr.30.3</i> <i>Urdhër mbi përbërjen e KSBC, Ref. nr.30.4. Plani i veprimit të KSBC, Ref.nr.30.1</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Materiale periodike, formulohen dhe shpërndahen brenda institucionit, për informimin e strukturave drejtuese dhe stafet pedagogjike e më gjërë. Mbi këtë bazë, raportet janë pjesë e diskutimit në rektorat.  <i>Metodologjia e punës së KSBC-Provimet, ref.nr.30.5</i> <i>Plani i veprimit të KSBC, Ref. nr.30.1</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Instrumenta që sigurojnë raporte vlerësuese për ecurinë e programeve të studimit, të drejtuara nga KSBC, informojnë në mënyrë periodike rezultatet. KSBC njëherazi rekomandon detyra të cilat ndiqen nga vetë komisioni dhe strukturat drejtuese. <i>Strategji për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022 Ref. nr 30.2</i> <i>Format i relacionit të KSBC për monitorimin e syllabuseve, ref.nr.30.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Me rezultatet e vlerësimeve informohen periodikisht, stafet drejtuese, stafet akademike, grupet studentore, përgjegjësit e grup lëndëve etj. KSBC njëherazi rekomandon detyra të cilat ndiqen nga vetë komisioni dhe strukturat drejtuese. Kjo ndodh periodikisht. <i>Strategji për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022 Ref. nr 30.2</i> <i>Format i relacionit të KSBC për monitorimin e syllabuseve, ref.nr.30.</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet periodike të vlerësimit, njëherazi adresojnë edhe mangësitë e vërejtura dhe propozojnë zgjidhje për përmirësimin e mangësive. Ky proces është sistematik dhe i monitoruar nga institucioni. <i>Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e syllabuseve, ref.nr.30.7</i> <i>Dokumenti F.VII, Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ref.nr.8</i>		
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

### Standardi VL3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i bërë nga KSBC në formatin e një raporti të përgjithshëm, u shërben njësive bazë për të gjetur problematikat për secilin sektor mëvete dhe përmirësuar ato. Secili sektor, merr nga materiali i hartuar, problematikat që lidhen me të.</p> <p><i>Plani i veprimit të KSBC, ref.nr.30.1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Përdoren monitorime lidhur me mbarëvajtjen e procesit akademik, cilësinë e leksioneve, të syllabuseve, rezultatet e provimeve etj. Përdoren metoda të drejtpërdrejta, të tërthorta, si dhe instrumenta specifikë, sipas veçorive të fushës së programit të studimit.</p> <p><i>Plani i veprimit të KSBC, ref. nr.30.1</i></p> <p><i>Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC, ref. nr.30.4</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për këtë qëllim përdoren, teste standarte vlerësimi me pikë, dëgjime audio, vlerësimi i detyrave të studentëve, kontrollet periodike dhe për stafin akademik, ndiqet kriteri i kontrollit në auditor nga titullari i departamentit, apo dekani, eprori.</p> <p>Disa nga metodat që ndiqen janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teste të standartizuara</li> <li>- Dëgjimi në auditor</li> <li>- Vlerësimi me pikë</li> <li>- Testime paraprake dhe përfundimtare etj</li> </ul> <p><i>GIII, 4.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu, ref. nr.30.8</i></p> <p><i>Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik, në situatën e krijuar nga pandemia Covid 19, ref. nr.5.1.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Përdoren forma të kombinuara vlerësimi si, sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimit, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista etj. Ndihmesa e ALUMNI është konkrete dhe e prekshme. Rezultatet u vihen në dispozicion Drejtuesve të Institucionit për përmirësime të mëtejshme.</p> <p><i>G.III.4.2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët, ref.nr.40</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UET ka arritur të sigurojë qasje si partner në disa programe europiane si projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti ERASMUS + QainAL, që sigurojnë efekt të drejtëpërdrejtë në cilësinë e brendshme të mësimdhënies. <i>Të dhëna për antarët e NJSBC, ref. nr.30</i> <i>Fisha e projektit ENCHASE, ref. nr.30.9</i> <i>Fisha e projektit QainAL, ref. nr.30.10</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë për sigurimin e cilësisë së brendshme i ngarkohen departamentit, stafit pedagogjik, sekretarisë, zyra e karrierës, kordinatorit të programit etj. KSBC ka rolin e vet në harmonizimin e brendshëm. <i>Statuti UET, Neni 11,16, 20.5,20.6, ref.nr.2</i> <i>Aneks, Për përcaktimin e detyrave të kordinatorit të programit të studimit, ref. nr.36</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET, përfshin përfaqësues të gjithë niveleve, nga stafi pedagogjik, nga administrata, nga përfaqësia e studentëve, nga personeli ndihmës akademik. <i>Dokumenti F:VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, ref. nr.8</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET, përbëhet nga persona të përzgjedhur mbi kritere korrekte si paanshmëria, kompetenca profesionale, aftësia për rezultate të prekshme etj. <i>Dokumenti F:VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F:VII.7, ref. nr.8</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përmbushja e këtij kriteri ndihmohet nga përfshirja e ekspertit të jashtëm, brenda strukturës së Komisionit të Vlerësimit të brendshëm të UET. Ky është një tregues i vlerësimit të faktorit të jashtëm, lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. <i>Të dhëna për antarët e NJSBC, ref. nr.30</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, vepron brenda UET, në bazë të një plani veprimi të përvitshëm, ku planifikohen monitorime të brendshme në sektorë dhe hartimi i raporteve që pasqyrojnë problematikat që lidhen me cilësinë. <i>Plani i veprimit të KSBC, ref. nr.30.1</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Për të dhëna të marra në terren, të dhënat e drejtpërdrejta trajtohen në departamente dhe kur ka probleme me ngarkesë të lartë e sensitive, ato bëhen objekt i diskutimit në stafin drejtues, duke zbatuar kodin e etikës. <i>Plani i veprimit të KSBC, ref. nr.30.1</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të dhënat e përfuara nga instrumentat e vlerësimit të brendshëm, pas përpunimit, shfrytëzohen gjerësisht nëpërmjet sistemit Folloë – Up, ku drejtuesit e UET, bëjnë vlerësimin e punës për çdo pedagog. <i>G:1.12.1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së stafit akademik, ref. nr.41</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	CROS CHECK, është instaluar për të mundësuar kontrollin e kryqëzuar i cili jep rezultate të vërteta në pasqyrimin e vlerësimit të cilësisë për çdo nivel, departament, staf mesimor, administratë, etj. <i>Statuti UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6, ref. nr.2</i> <i>Aneks: Për përcaktimin e detyrave të kordinatorit të programit të studimit, ref. nr.36</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Ky standart arrihet nëpërmjet përfshirjes së studentëve në KSBC dhe në Senatin e UET, ngritja dhe funksioni i Këshillit të Studentëve, si dhe javës orientuese që zhvillohet periodikisht. <i>Statuti UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6, ref. nr.2</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", me profile: "Atletikë", "Gjimnastikë", "Futboll", "Lojra me Dorë", "Gazetari" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**



1. Ndryshimi i kampusit të ri me hapësira më të mëdha për pjesën teorike të programit të studimit dhe paisja me teknologji moderne e bashkëkohore informacioni, ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ka impakt të drejtpërdrejtë pozitiv në drejtim të arritjeve të objektivave të mësimdhënies e mësimnxënies të programit të studimit;
2. Marrëdhënie bashkëpunuese me tregun e punës me subjekte publike dhe jopublike, që janë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e programit të studimit e që i kontribuojnë cilësisë së praktikave profesionale të studentëve;
3. Programi operon mbi një repertor të gjërë disiplinash që thellojnë dijen rreth shëndetit dhe rreth edukimit fizik dhe sporteve dhe institucioni ofron mundësinë për vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve në ciklin e dytë në fushën e edukimit fizik dhe sporteve;

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e gradave dhe titujve tek shumica e pedagogëve që përbëjnë themelin e këtij programi studimi, tek pedagogët e shkencave dhe praktikave sportive.
2. Aftësitë praktike profesionale që duhet të sigurojë programi i studimit për studentët duhen mbështetur me investime të brendëshme serioze në drejtim të mjediseve, ambienteve, paisjeve sportive bashkëkohore të standarteve olimpike, laboratorëve të matjes së cilësive fizike apo parametrave fizike të domosdoshme për realizimin cilësor të programit të studimit.
3. UET duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike në të ardhmen e afërt.

**Rekomandime:**

1. Investimet në mjediset, sallat sportive, palestrat, paisjet me setet bashkëkohore sportive, labororet specifike të performancës fizike në UET janë në hapat e para, por ka ende punë dhe nevoja investimesh serioze për të ardhmen.
2. Departamenti përgjegjës i këtij programi studimi duhet të mundësojë në vazhdim një studim të mirëfilltë tregu sidomos për studentët e diplomuar.





3. Problem është vendosja si titullar lëndësh sportive i stafeve MSc, kur në institucione të tjera në këto pozicione janë vetëm stafe akademike të kategorisë "Profesor".
4. Mbetet shumë i rëndësishëm kualifikimi i stafit akademik MSc të cilët duhet të jenë më aktivë në studime shkencore, referime apo botime si brenda ashtu edhe jashtë vendit si një detyrim vjetor akademik.

**Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Physical Education and Sports", with profiles: "Athletics", "Gymnastics", "Football", "Hand Games", "Journalism" of the Higher Education Institution "European University of Tirana"**

**Strengths and Affirmations:**

1. The change of the new campus with larger spaces for the theoretical part of the study program and the equipment with modern and contemporary information technology, directly affects the smooth running of the teaching process and has a direct positive impact in terms of the achievement of teaching objectives and learning of the study program;
2. Collaborative relationship with the labor market with public and non-public entities, which are directly related to the field of the study program and which contribute to the quality of the students' professional practices;
3. The program operates on a wide repertoire of disciplines that deepen knowledge about health and about physical education and sports, and the institution offers the possibility for further continuation of studies in the second cycle in the field of physical education and sports;

**Weak points:**

1. The lack of degrees and titles among the majority of the pedagogues who form the foundation of this study program, among the pedagogues of sports sciences and practices.
2. The professional practical skills that the study program must provide for students must be supported with serious internal investments in terms of environments, facilities, contemporary sports equipment of Olympic standards, laboratories for measuring physical qualities or physical parameters necessary for the qualitative realization of study program.
3. UET should do more in terms of signing agreements with foreign HEIs that offer the same or similar study programs, which would enable the functioning of mobility for students and academic staff in the near future.


**Recommendations:**

1. Investments in the environments, sports halls, gymnasiums, equipment with modern sports sets, specific physical performance laboratories in UET are in the first steps, but there is still work and serious investment needs for the future.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





2. The responsible department of this study program should continue to enable a genuine market study, especially for graduate students.
3. The problem is the placement of MSc staff as holders of sports subjects, when in other institutions there are only academic staff of the "Professor" category in these positions.
4. It remains very important to qualify MSc academic staff who should be more active in scientific studies, references or publications both at home and abroad as an annual academic obligation.

### Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përbushjen	Përbushjen pjesërisht	Përbushjen kryesisht	Përbushjen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X